



NE KLIMEN E PERSHPIRTSHMERISE

# *Haxhi Ideal dhe Umreja*

Osman Nuri TOPBASH



Progresi Botime





ISTANBUL 1428 /2007



**Progresi Sh.p.k**

---

**Adresa:** L: Vasil Shanto Rr: Çajupi  
Shkodër / Shqipëri

**Tel:** +355 20 76 768

---

**Dizajner:** Anar Gasimov / Bledar Xama

*Haxhi Ideal  
dhe Umreja*

NE KLIMEN E PERSHPIRTSHMERISE

Osman Nuri TOPBASH



## PARATHENIE

*Laudi dhe falenderime të panumërta i qofshin Allahut (xh.sh.) i Cili na tregoi rrugën që na shpie tek Ai duke na bërë fatlumë me begatinë e ndjenjës së besimit dhe të adhurimit.*

*Përshëndetje dhe fjalë laudi i qofshin Muhamedit (a.s.), Dritës së Gjithësisë, Ndërmjetësuesit tonë në botën e përtejme, udhërrëfyesit të gjithë njerëzimit i cili është shembulli i pashoq i formës më të bukur të robërisë që të shpie në rrugën e Allahut (xh.sh..)!*

Qenia njerëzore rrethohet nga nevoja materiale dhe shpirtërore që nuk kanë të mbaruar. Disa nga këto nevoja janë të domosdoshme dhe jetike për të. Fjala vjen, që trupi të gjallojë duhet të thithë ajër, të pijë ujë dhe të konsumojë lëndët e nevojshme ushqimore. Po kështu edhe bota afektive shpirtërore ka disa nevoja të domosdoshme, që janë jetike për të. Madje këto nevoja janë më të rëndësishme se ato trupore-fizike, sepse trupi është udhëtar i dheut, ndërsa shpirti është udhëtar i jetës së përtejme.



Në këtë kontekst Allahu (xh.sh..) aludon rreth ushqimit shpirtëror të njeriut, kur thotë: **“Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.”** (edh-Dharijat, 22). Në fakt, Ai na e ka dhuruar ushqimin shpirtëror në formën e adhurimeve, të cilat bëhen burim qetësie shpirtërore. Për këtë arsye të gjitha adhurimet fetare, jo vetëm që janë akte të urdhëruara nga Allahu (xh.sh..), por edhe përbëjnë nevojën shpirtërore më të pashmangshme për njeriun. Kështu që shpirti dhe bota afektive nuk mund ta sigurojnë askund tjetër atë ushqim që marrin nga kryerja e adhurimeve. Njerëzit e ditëve të sotme që nuk e kuptojnë këtë të vërtetë, nuk mund të bëjnë asgjë tjetër, veçse të rrinë dhe të bëjnë sehir se si shpirtat e tyre përpëlitën në rropatje. Ndërsa fatlumët që mund të marrin ushqimin e shpirtit, brenda një klime tjetër që është e mbushur me prehje dhe harmoni, i shndërrojnë edhe bren gat e dhimbjet e kësaj bote në ngazëllim, madje, ndërtojnë një jetë mbi bazat e dashurisë shpirtërore dhe orientimit në rrugën e drejtë, sepse shija dhe frymëzimi hyjnor që ndiejnë, i pengon të bien brenda vorbullës së pistë të kësaj bote.

E thënë shkurtimisht, disa adhurime janë bërë të detyrueshme për njeriun, në mënyrë që ai të plotësojë nevojat e tij shpirtërore dhe të shndërrohet në një rob që sillet me mirënjohje para begatave të panumërta të Zotit dhe që jeton me ndjenjën e falenderimit për Të. Kjo gjë i ngjan doktorit që shkruan recetën, ku shënon ilaçet dhe i kërkon të sëmurit t’i pijë patjetër ato, nëse



do që të shërohet. Kjo ndodh për arsye se njerëzit shumë herë, qoftë për shkak të përtacisë së tyre, qoftë për shkak të mosnjohjes siç duhet të këtij problemi jetësor, tregojnë indiferencë ndaj nevojës së tyre për të kryer adhurimet. Për këtë arsye Allahu (xh.sh..) duke i shpallur obligime të pashmangshme adhurimet që përbëjnë nevojën më jetike për shpirtrat e njerëzve, dëshiron që nëpërmjet tyre, t'i shpëtojë ato nga privimet e pafundme.

Nuk ka dyshim se në krye të këtyre adhurimeve jetike është **namazi**. Ai është obliguar i pari nga adhurimet, sepse në namazin që falet siç duhet, perdet e zemrës hapen dhe përjetohet një takim i papërshkrueshëm në audiencën e Allahut, realitet që shprehet me fjalët: “**Namazi është miraxhi i besimtarit**”. Ky takim bëhet realitet pas kryerjes me vetëdije të urdhrit të Allahut (xh.sh..) “**Bjer në sexhde dhe afromu Mua**”.

Një tjetër adhurim i domosdoshëm që ushqen shpirtrat tanë, është edhe **agjërimi**. Ai është i rëndësishëm, sepse ndihmon në formimin sa më të mirë të moralit tonë nëpërmjet edukimit të durimit, vullnetit dhe parandalimit të dëshirave epshore. Ai i kujton njeriut vlerën e begative që i ka dhuruar Allahu (xh.sh..) dhe e ndihmon të mendojë thellë për pozitën sociale ku ndodhen të uriturit, të varfërit dhe ata që përpëliten në mundime të shumëllojshme. Gjithashtu, agjërimi, duke e privuar njeriun për një kohë të caktuar nga të mirat e pasurisë, e bën të shijojë hallet e të

varfërve dhe të të uriturve duke e barazuar me ta në këtë aspekt. Kështu, ai bëhet shkak që tek njerëzit e pasur të zhvillohen ndjenjat e ndihmës dhe të mëshirës.

Në rregullin shoqëror Feja Islame ka urdhëruar edhe dhënien e ndihmës në format “**zekat**” dhe “**dhurim**” me synim që të ndërtojë urën e dashurisë ndërmjet të varfërit dhe të pasurit, si dhe të zhdukë armiqtë që mund të lindë nga dallimi i pasurisë. Gjithashtu, me kryerjen e këtij farzi, mund të arrijmë sa e sa urtësi, siç janë: vënia pritë shturjeve të mundshme që mund të vijnë si rezultat i dhënies pas pasurisë (sidomos e njerëzve të kamur), parandalimi i fillesave të tendencave negative të nevojtarëve përkundrejt të pasurve, ruajtja e ekuilibrit në jetën shoqërore etj.

Përkrah këtyre adhurimeve ekziston edhe një adhurim tjetër që kryhet si nga ana financiare, ashtu edhe nga ajo fizike. Ai është **haxhi**.

Haxhi është një adhurim i rëndësishëm që përsos besimin në shpirtëra dhe na bën që të përjetojmë që në këtë botë, një pamje të ngjashme me atë të mahsherit. Ai na ndihmon që të mbërrijmë në enigmën e fjalëve: “**Vdisni para se t’ju vijë vdekja!**”.

Por duhet pasur parasysh se aspekti shpirtëror dhe moral i haxhit paraqet më shumë rëndësi se sa aspekti formal i jashtëm që ka. Edhe haxhi, të cilin profeti Muhamed (a.s.) e emërtonte me fjalët “haxhi i pranueshëm”, është një adhurim, i cili karakterizohet fund e krye nga hijeshia e

cila konsiston tek mbushja me vlera shpirtërore. Nga ky aspekt haxhi është ura e shpirtërave për tek mëshira, begatia dhe virtytet hyjnore, gjë që realizohet me anë të lutjes, pendesës dhe kërkesës për falje të mëkateve të kryera. Haxhi është rimëkëmbja e një jete të tërë me vepra të mira. Por nuk duhet të harrosh **t'i japësh fjalën Allahut (xh.sh.) se kjo botë shpirtërore ku jeton, do të vazhdojë edhe pas kryerjes së haxhit.**

Teksa flet rreth synimit të këtyre adhurimeve të bekuara që fitohen me anë të veprave të mira që bëhen gjatë kryerjes së obligimeve të haxhit dhe umres, I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: *“Kryejini në një kohë Haxhin dhe umren, sepse këto adhurime i pastrojnë mëkatet ashtu siç e pastron kaceku ndryshkun që ka zënë hekurin.”* (Nesai, Menasik, 6; Ibn Maxhe, Menasik, 3)

Ja pra se sa e rëndësishme është kryerja e adhurimit të umres, sepse bëhet shkak për pastrimin, përtëritjen shpirtërore dhe rifreskimin e besimit. Në hadithin fisnik këshillohet që adhurimi i **umres** “të kryhet në një kohë së bashku me haxhin”.

Përveç adhurimit të haxhit që është i obliguar të kryhet një herë të vetme në jetë dhe brenda ditësh të caktuara, duhet ta perceptojmë mirë edhe vlerën që ka adhurimi i umresë. Duke pasur parasysh vlerat e larta që ka, duke pasur parasysh se është një akt që mund të kryhet në çdo kohë të vitit dhe sa herë të dëshirojmë, ajo është cilësuar ndryshe edhe si “haxhi i vogël”.

Pika ndaj së cilës duhet treguar më shumë kujdes gjatë gjithë këtyre adhurimeve është kush-ti që ato të kryhen me sinqeritet dhe me zemër të paqtë. Në qoftë se dëshirojmë që të qenit tonë rob ndaj Allahut të pranohet në audiencën e Tij (xh.sh..), zelli dhe përpjekjet tona duhet të jenë të orientuara ndaj kryerjes me dashuri dhe edukatë të adhurimeve tona. Vetëm atëherë adhurimet tona do të vishen me cilësinë e punës së mirë dhe do të shndërrohen kështu në kapitalin tonë të lumturisë për botën e përtejme.

Edhe ne në këtë libër tonin të përkorë, jemi përpjekur t'i themi me pak fjalë rregullat dhe edukatën me të cilën duhen kryer adhurimet e haxhit dhe umresë duke u fokusuar tek kriteret e aspektit shpirtëror dhe të përkushtimit. Shkrimet tona të botuara në libra apo në formë artikujsh, hartuar në lidhje me këtë çështje vite më parë, ua prezantuar vëllezërve tanë të fesë, të cilët kërkuar të mësojnë dhe të informohen në mënyrë të përmbledhur dhe të shkurtër rreth këtyre aspekteve të rigrupuara dhe të ritrajuara në një formë të re.


**Allahu (xh.sh..) na mundësoftë kryerjen e përhershme të të gjithë adhurimeve tona brenda kriterëve të principialitetit dhe përkushtueshmërisë! Na e bëftë namazin, shokun e përhershëm të rrugës; agjërimin që mbajmë, mikun më të afërt; zekatin dhe ato që dhurojmë në emër të fesë, sillën tonë të përjetshme dhe Haxhin që kryejmë, mikun tonë të zemrës për në rrugën tonë drejt ahiretit! Na bëftë të**

**mundur të gjithë neve që të mund t'i kryejmë  
çdonjërën nga këto adhurime, ashtu siç i ka  
hije prehjes hyjnore!**

**Amin!**

Osman Nuri TOPBASH  
Gusht 2006  
Yskydar











## HAXHI IDEAL DHE UMREJA

**H**axhi si një nga shtyllat e Islamit është një adhurim financiar dhe trupor. Për ta kryer këtë adhurim të shumëvlershëm siç duhet, nevojitet një zemër e pjekur, një besim i plotësuar dhe një aftësi e madhe perceptuese.

Haxhi është një ibadet i shenjtë, i praktikuar që nga Ademi (a.s.), si i pari i vargut profetik, e deri tek i fundit i këtij vargu, Muhamedi (a.s.). Të gjithë realizuan një mahsher të ngjashëm me atë të botës tjetër, duke provuar brenda vetes "*vdekjen para vdekjes*".

Ademi (a.s) së bashku me Havanë (a.s.) njerëzit e parë prej ku buroi njerëzimi, shenjtëruan Qaben në Meke si Xhaminë e parë, për të përhapur fenë e për të jetuar në klimën e saj. Pasardhësit e tyre ndërruan vendndodhje si rezultat i ndryshimit të kushteve të jetës. Më vonë, me kalimin e kohërave dhe gjeneratave, njerëzimi ndryshoi. Ai u largua nga feja e vërtetë, prandaj edhe Qabja me humbjen e shenjtërimin të saj, u shkatërrua. Më



vonë Ibrahimimi (a.s.) e rindërtoi dhe u lut për të. Allahu (xh.sh..) për këtë çështje në Kuran thotë:

(Kujtoje) kur Ibrahimimi tha: "O Zoti im! Bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!

O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë.

O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë. (Ibrahim, 35-37)

Adhurimi i haxhit ishte edhe para Islamit. Mirëpo mushrikët<sup>1</sup> e kishin kthyer atë në një ceremoni zyrtare të shfaqjes së imoralitetit që bëhej për parinë e tyre. Përveç kurejshëve të cilët e bënë haxhin të veshur në përputhje me rregullat e moralit, pjesa tjetër e arabëve e kryente këtë peligrinazh zhveshur e të përzier së bashku burra e gra. Mbulimi i pjesëve të turpshme të grupeve që vinin në Qabe varej nga bujaria e kurejshëve. Pra, nëse kurejshit do t'u jepnin rroba, ato do të mbuloheshin e nëse jo, do ta bënë tavafin<sup>2</sup> laku-

1 **Shënim:** Sqarimet e bëra në fund të faqeve të librit, janë të përkthyesve. **Mushrik:** Politeist

2 **Tavaf:** Rrotullimi shtatë herë rreth Qabes duke filluar nga këndi ku ndodhet Haxheru'l-Esvedi.

riq. Ndërsa me gjakun e kurbanit që pritnin, përlyenin muret e Qabes, kurse mishin e digjin.

Më në fund, aty ku filloi të përhapej mesazhi hyjnor, erdhi edhe peygamberi i fundit i njerëzimit, Muhamedi (a.s.). Ai përsosi profetësinë dhe zhdukuri këto zakone të turpshme e bestytni duke i kujtuar njerëzimit se qëllimi i të gjitha adhurimeve ishte përmendja e Zotit dhe pendimi ndaj Tij.

Peygamberi (a.s.) jetoi dhe ndërtoi asr-i saadetin<sup>3</sup> me qendër Meken dhe Medinen. Kështu që këto qytete u bënë qendrat e Islamit e të myslimanëve.

Vendet e haxhit janë begatuar me zemrat e mbushura me besim dhe me lotët e derdhur për Zotin të haxhinjve që nga Ademi (a.s.) e deri në ditët e sotme. Ato që bëjnë haxhin me përkushtim shpirtëror i kushtojnë kujdes faktit të mësipërm; ato kërkojnë gjurmët shpirtërore të peygamberëve aty dhe duke kujtuar këto, pajisen me një kënaqësi të thellë. Këto vende të shenjta janë një burim i veçantë qetësie e kënaqësie sepse janë të mbushur me kujtimet e vargut të peygamberëve. Atje, të bie ndërmend vazhdimisht mëshira, falja dhe begatia e Allahut (xh.sh..).

Vizituesit e Qabes me qëllimin e mirë për ta kryer haxhin ose umren, bëhen merituesit e kënaqësive shpirtërore, duke recituar duanë e Ibrahimit (a.s.):

3 **Asr-i saadet:** *periudha e lumtur, epoka e ndritur; periudha kur jetoi Profeti Muhamed (s.a.s.).*

**O Zot! Na fal mëkatet tona! Ti je më i madhi  
mëshirues e mëshirëbërës. O Zot! Bëje ithtar e  
udhëtar të fesë sime fëmijën tim!**

Kështu, zemrat e besimtarëve janë ndezur nga malli e dashuria për këto vende, dhe shpesh kanë thurur vargje dashurie:

*U verbova, s' shoh as afër e as larg  
duke të mbërritur, o e bukura Kabetullah<sup>4</sup>*

*O fllad i mëngjesit, të rëntë rruga Haramejnit<sup>5</sup>  
Ma dërgo selamin tek Resuli i Thekalejnit<sup>6</sup>*

Këto shfaqje të dashurisë u thelluan e u jetuan kaq shumë, sa që u bë traditë të përcillet haxhiu me porosinë e dërgimit të selameve ngado që shkon. Këto amanete të mbushura me dashuri, që i pëshpëriten haxhiut në vesh, poeti, i përshkruan kështu:

*Rrugëve ku kaloni  
Buqeta selamesh dërgoni!  
Njerëzve që përmendin Zotin  
Dërgojini selam prej nesh!...*

*Kryerës të haxhit  
si bora, të pastrit  
Profetit Muhamed  
Dërgojini selam prej nesh!...*

4 **Kabetull'Ilah:** Qabja e Allahut.

5 **Haramejn:** dy vendet që meritojnë respekt, Meke dhe Medine.

6 **Resuli Thekalejn:** Pejgamberi i njerëzve dhe xhinëve.

*Mekes dhe Medines  
Dy thesareve të vetme  
Profetit Muhamed  
Na i jepni selam!...*

*Duke thënë lebbejk  
Vraponi kah zemzemi  
Fisit Beni Hashim  
Na i jepni selam!...*

*Hyrësve në ihram<sup>7</sup>  
Të panjollosurve me haram  
Sahabeve të ndershëm  
Na i jepni selam!...*

*Përgjërues ndaj Zotit  
Bani dua edhe për ne  
Qabes së shenjtë  
Përcilljauni selamet tona!...*

*Hyrësve në kopshtin e dashurisë  
që s'bien në helmin e pavetëdishmërisë  
Atij mali të nurtë  
Përcilljuani selamet tona!...*

*Hyrësve në zemrën e hatimit  
Bëjini sexhde rrahimit  
Makamit të Ibrahimit  
Përcilljuani selamet tona!...*

---

7 **Ihram:** Veshja e rrobës së haxhit dhe ndalimi nga disa gjëra të caktuara.



*Shpëtimit që vjen nga Zoti  
Të gjitha flatrave të hapura  
Minasë dhe Arafatit  
Jepini selam ...*

*Parajsës së përhershme  
Trëndafilishtes së bekuar  
Trëndafilishtes së pastër  
Jepini selam ...*

Shumë dijetarë të Islamit, të djegur nga dëshira e dashuria për këto vende të shenjta, nuk ndiheshin të qetë derisa gjenin mundësinë të shkonin dhe t'i vizitonin dhe derisa arrinin të kryenin faljen e namazeve, gjë që e bënë me një kënaqësi të madhe shpirtërore. Bile, disave prej atyre që nuk kishin mundësitë e mjaftueshme ekonomike për ta bërë këtë udhëtim, u dhurohej një mundësi shpirtërore për ta realizuar haxhillëkun. Dihet rasti që u bë shkak për t'i hapur krahët qiejve të tasavvufit<sup>8</sup>, Aziz Mahmut Hydajit. Me të ndodhi kështu:

Në vitet kur Aziz Mahmut Hydaji ishte kadi i Bursës, i erdhi një çështje shumë e rrallë që duhej ta zgjidhte. Një grua, duke u ankuar për të shoqin, i tha:

– Zotëri gjykatës! Bashkëshorti im planifikon çdo vit të shkojë në haxh, por nga varfëria nuk mund ta realizojë. Edhe këtë vit dëshiroi të shkojë dhe më tha: "Në qoftë se nuk shkoj në haxh edhe këtë vit, do të të ndaj."

Pastaj afër festës së Kurban-Bajramit u fsheh diku e s'u duk fare. Pas pesë gjashtë ditësh erdhi dhe më tha se kishte qenë në haxh. Si mund të ndodhë një gjë e tillë? Zotëri gjykatës! Unë dua të ndahem nga ky njeri gënjeshtar!...

Gjykatës Mahmuti për ta studiuar edhe më mirë ankesën e gruas, thirri bashkëshortin e saj dhe e pyeti nëse ankesa e bashkëshortes së tij ishte e vërtetë. Burri iu përgjigj duke thënë:

– Zotëri gjykatës! Thëniet e gruas sime janë të vërteta, por edhe të miat janë të tilla. Dijeni mirë se unë kam qenë në haxh. Atje kam takuar edhe disa haxhinj nga Bursa dhe i kam lënë porosi të më bien disa dhurata prej atje.

Gjykatësi Mahmut, i çuditur, pyeti:

– Si mund të ndodhë diçka e tillë, zotëri?!

Burri u përgjigj:

– Si çdo vit tjetër, edhe sivjet u pushtova nga një mërzi e madhe prej pamundësisë së shkuarjes në haxh. Shkova tek **Mehmed Dede**. Ai më mbajti duart dhe më tha që t'i mbyllja sytë. Kur i hapa, e pashë veten në Qabe!...

Mahmut Efendiu i habitur nga një ngjarje e tillë, e cila ishte edhe e para e këtij lloji, e refuzoi.

Burri, që ishte akoma nën ndikimin e haxhit, iu përgjigj shumë thjesht, por saktë këtij refuzimi:

– Zotëri gjykatës! Armiku i Zotit, shejtani, mund të shëtisë gjithë botën për një moment. E si të mos mundet një mik i Zotit të shkojë në Qabe?!

Gjykatësi pa se përgjigjja e dhënë kishte logjikë, prandaj e shtyu për më vonë vendimin në lidhje me këtë çështje. Kur u kthye karvani i haxhinjve, Mahmut Efendiu e studioi çështjen edhe një herë dhe arriti në përfundimin e vërtetësisë së fjalëve të burrit. Çështja u mbyll, por në zemrën e tij u ndez një zjarr i madh misteri. Me ndihmën e Mehmet Dedesë, ai hyri në grupin e nxënësve të mësuesit Yftade, prej ku doli si një nga dijetarët më të mëdhej shpirtërorë.

Malli dhe nevoja për të parë vendet e shenjta nuk lidhet shumë me dheun e shkretëtirës. Qëllimi i shkuarjes atje lidhet me dëshirën për të parë vendin e Ibrahimit (a.s.), atdheun e Ismailit dhe të bijve të tij, për të parë vendlindjen e Muhamedit (a.s.), vendin prej nga ku u përhap Islami dhe për të mbushur mushkëritë dhe shpirtrat tanë me ajrin që thithi profeti i fundit i njerëzimit. Sikurse thotë edhe poeti i madh:

*"Kudo ku hedh sytë, vetëm mrekulli, përkrah zemrës ajo më thotë: Vendi i vërtetë është pikërisht ky."*

Këto shprehje nuk janë vetëm një frymëzim poetik, por në të njëjtën kohë edhe një e vërtetë kuranore. Allahu (xh.sh..) thotë:

فِيهِ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ

*" Aty ka shenja të qarta..." (Ali Imran, 97)*

Prandaj, kur njerëzit i shohin me sytë e zemrës ato vende të shenjta, tek ata zgjohen vlerat e



besimit dhe dashuria hyjnore rrok çdo krijesë. Ngado që ato hedhin shikimin, preken nga frymëzime dehëse dhe nga sytë u rrjedhin lotë e gjuhët u lëvizin vetëm për të përmendur Zotin (xh. sh..). Në ato vende të shenjta, e gjithë koha kalohet me një moral të lartë. Për këtë Allahu (xh.sh..) në Kuran thotë:

وَمَنْ يُعَظِّمْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

**"...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij"** (el-Haxhxh, 32)

Parë nga ky aspekt, haxhi nuk është vetëm një adhurim material. Ai është më shumë adhurim shpirtëror. Ajo që Muhamedi (a.s.) kishte për qëllim me "haxhxhu'l-mebrur"<sup>9</sup>, ishte pikërisht haxhi i pajisur me këto vlera shpirtërore. Pra, haxhi është mëshirimi i shpirtërave nga Zoti (xh. sh.); furnizimi me virtyte të larta nëpërmjet lutjeve, tevbeve dhe pendimeve; mpleksja e jetës me vepra të mira; fjalë që i jepen Zotit për vazhdimësinë tonë në këtë rrugë edhe mbas haxhit.

Sa e bukur tingëllon duaja e Ibrahimit (a.s.):

**"Zoti ynë, bëna besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë njerëz të bindur ndaj Teje. Na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) dhe falna neve, vërtetë Ti je që fal shumë, je mëshirues!"** (el-Bakara, 128)

9 Haxhxhu'l-mebrur: Haxhi i pranueshëm.

Kështu haxhinjtë brumosen me këtë dua duke kujtuar se Pejgamberi (a.s.) ka jetuar e shëtitur aty përreth. Aty janë gjurmët e tij, përpjekjet e pafundme që ai bëri për të përhapur Islamin ...e ... sa e sa ndodhira të tjera. Kujtojnë kohën kur Muhamedi (a.s.) ligjëroi para mushrikëve në kodrën Safa. Ato kujtojnë pejgamberin që duke i treguar mekasve malin Ebu Kubejs, tha:

– Në qoftë se unë ju them se prapa këtij mali ndodhet një armik që është drejtuar për t’ju vrarë dhe duhet të organizoheni për të mbrojtur vetveten, a do të më besonit?

Ato iu përgjigjën:

– Do të të besonim, edhe nëse nuk do të mund të shihnim pas malit. Ti je “Muhammedu’l-Emin”<sup>10</sup>, ne nuk dyshojmë aspak tek ti.

Pas kësaj Muhamedi (a.s.) tha:

– Nëse nuk dyshoni aspak tek unë, atëherë besoni se Krijuesi i gjithësisë është një! Idhujt që adhuron janë vetëm gurë të paforcë. Largojuni atyre dhe adhuron Allahun si një të vetëm. Dijeni se Allahu (xh.sh..) më dërgoi mua si pejgamber tek ju.

Mushrikët, me në krye Ebu Lehebin, thanë:

– Për këtë na thirre, o Muhamed?

Pastaj u larguan duke i përgënjeshtuar fjalët e Muhamedit (a.s.), edhe pse ndërgjegjja e tyre i pranonte ato.

<sup>10</sup> **Muhammedu’l-Emin:** Muhamedi i sigurt, i besueshëm.

Por Zotëria i botërave nuk u thye para këtyre devijimeve e kundërshtimeve të kota, por u shërbeu atyre njerëzve me shpirt të tharë, si një burim uji jetësor.

Duke menduar të tilla ngjarje me shpirt të gatshëm për të marrë diçka para Daru'l-Erkamit, i cili shërbeu si mësues, ne mund të përjetojmë reflektimet e edukimeve kuranore, mund të zgjatemi deri tek hixhreti, e bile edhe pas periudhës së tij, kur Zoti zbriti mirësinë e begatinë e Tij.

Edhe ne mund të përjetojmë marrëdhënien e profetit me Ebu Bekrin në shpellën Thevr, zhytjen e tyre në misteret hyjnore e në edukimet shpirtërore për tre ditë me radhë. Në atë bashkëbisedim të fillesës së raportit dashuroro-mistik, mund të shijojmë në mënyrë të plotë besimin.

Duke ndier kaq thellë besimin, mund t'u drejtohem sahabeve për t'i marrë si shembull, pasi secili prej tyre është si një yll i shndritshëm; mund të kujtojmë periudhën e Medines e më pas kthimin në Meke, dhe çlirimin e saj nga Profeti (a.s.).

Duke parë malet përreth, mund të kujtojmë si në ëndërr ushtrinë e sahabeve të profetit Muhamed (a.s.) të cilët për t'i frikësuar mushrikët, kishin mbledhur materiale që ndizeshin e me to kishin bërë pishtare. Mund të dëgjojmë ezanin e ëmbël që Bilali këndoi në Qabe. Rrëzimin që Profeti (a.s.) u bëri idhujve duke thënë ajetin:

**"...E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua ..."** ( el-Isra, 81 )

Duhet të dimë edhe se zemra jonë është si një Qabe. Edhe aty mund të ketë disa idhuj të egos sonë dhe haxhi shërben për t'i thyer ato e për ta shndërruar atë në një vend hyjnor.

Pra, haxhi është një ibadet i shumëplanshëm që shërben për pastrimin shpirtëror, kthjellimin dhe ngjalljen e njeriut.

Haxhi është një përpjekje për të hedhur një hap drejt botës shpirtërore, duke u zhveshur nga bota materiale. Tek haxhi, shpirti gjen harmoninë, klimën, ngjyrën, vetveten. Ai, gjatë këtij ibadeti, lahët me shiun e kënaqësive të shfaqjeve shpirtërore.

## ARAFATI

**Arafati**, një vend për falje dhe strehim.

Arafati, të kujton ngritjen nga varri në mëngjesin e kijametit dhe grumbullimin grupe-grupe në sheshin e gjykimit. Të gjithë robërit e pa-fuqishëm: nevojtarë dhe optimistë presin falje. Shpirtrat dhe sytë lagen nga lotët e pendimit dhe një det fjalësh të sinqerta i kushtohen Drejtësisë. Hapen faqe të pastra për njerëzit, të cilët i japin fjalën Zotit se do të jetojnë me bindje të plotë në pjesën tjetër të jetës së tyre.

Kështu, Arafati paraqet një tabllo gjykimi. Një pjesë e gjendjes së ditës së kijametit jetohet edhe aty. Me të vërtetë që ai vend gati-gati të kujton ngritjen e njerëzve nga varri, ardhjen e tyre në vendin e mahsherit, sheshit të grumbullimit,

ku secili është në hallin dhe telashin e vet me pendimet e gjynaheve dhe lutjen e përzemërt që i bën Zotit, i futur në një parrugëzgjdhje: secili me kokë të zbuluar ... i mbështjellë me një peshqir poshtë dhe lart... këmbëzbathur ... i zhveshur nga të gjitha gradat e kësaj bote...

Nga ana tjetër Arafati na çon në kujtimet e shkuara. Është e njohur edhe historia e Hz. Adem-it dhe e Havasë të cilët hëngrën nga pema e ndaluar dhe si rrjedhojë u dënuan nga përcaktimi hyjnor për të dalë nga xheneti dhe për t'u vendosur larg, në vende të ndryshme me qëllim që të ndienin mall për njëri – tjetrin.

Më në fund Ademi (a.s) kërkoi falje nga Zoti i Madhëruar duke menduar personalitetin dhe nderin që kishte Muhamedi (a.s) nga ana e Allahut. Më pas Allahu Te'ala e pranoi kërkesën e tij dhe caktoi një ëngjëll për t'i treguar rrugën drejt Mekës. Nga begatia e kësaj lutjeje edhe Havaja që jetonte në Xhidde u përcoll për tek Ademi (a.s) nën shoqërinë e një ëngjëlli tjetër dhe këto në një ditë arefe, në kohën e iqindisë, u takuan në luginën e Arafatit, ku qanë së bashku dhe bënë tevbe.

Allahu i Lartë, i cili jep dhunti dhe dhuron mirësi të pafundme, jo vetëm që i pranoi lutjet e tyre, por edhe u premtoi falje deri në ditën e kijametit të gjithë atyre që vinin nga ajo gjeneratë e që do të kërkonin të faleshin, duke ardhur çdo vit, në të njëjtën orë dhe në të njëjtën ditë. Ja pra, kjo është



të edhe arsyeja që haxhinjtë në ditën e arefesë<sup>11</sup>, ngjiten në Arafat dhe kërkojnë falje.

Pas këtij takimi, Ademi (a.s) së bashku me Havanë, me urdhër të Zotit, qëndruan në vendin ku sot ndodhet qyteti i Mekës. Kjo është edhe arsyeja që një tjetër emër i qytetit të Mekës është edhe “Ummu’l-Kura” që do të thotë nëna e zonave të qendrave të banimit.

Kjo ndodh pasi Meka është vendpasqyrimi i një të vërtete ku hiqen nocionet relative dhe të përkohshme të atdheut, ngjyrës, pasurisë, varfërisë, veshjes dhe ku të gjithë njerëzit ndihen si një popull i vetëm në vëllazërimin Islam. Aty, drejtuesi e punëtori, i pasuri dhe i varfri, injoranti dhe dijetari, që të gjithë janë së bashku, me të njëjtat veshje, në të njëjtin shesh dhe në të njëjtin rresht. Aty është vendi për t’iu mbështetur Zotit duke u zhveshur nga dallimet klasore të përkohshme dhe duke hyrë në hapësirën e qefinit. Aty është vendi i rrënoqethjes së trupit nga pamjet e tmerrshme të kijametit.

Ky qytet i madhërueshëm është prehri i sigurisë, qetësisë dhe dashurisë; është këndi i pejjamberëve që mbushin zemrat me begati dhe mëshirë. Megjithë vuajtjet e botës Islame në ditët e sotme, pasqyrimi i vëllazërimit, bashkimit dhe dashurisë i formuar në këto vende të madhërueshme në kohën e haxhit dhe të umres vazhdon t’i zbukurojë. Këto vende jetojnë përherë me dëshiri-

11 **Dita e arefesë:** Dita e nëntë e muajit Dhu’l-hixhxe, një ditë para Kurban Bajramit.

rën e zjarrtë për të arritur një gjë të tillë me organizatat ndërkombëtare që kanë krijuar dhe në këtë drejtim akoma nuk kanë arritur një mirëkuptim. Kjo, pasi përkundrejt qetësive materiale që i tejkalojnë edhe ngopjet e tyre, nuk mungojnë edhe erërat e ndarjeve të pafundme, urrejtjeve, dhunës, padrejtësive dhe armiqësive që fryjnë brenda dhe jashtë tyre, për shkak të shkatërrimit shpirtëror që përjetojnë.

## MUZDELIFE DHE KURBANI

Muzdelife, stacioni që vjen pas Arafatit, është vendi ku shihet qartë mëshira, është vendi i përgatitjes së zemrave me pranimin e fuqisë së Allahut dhe nënshtrimin ndaj madhësisë së Tij, është vendi i drejtimit vetëm nga Allahu, është vendi i dashurisë dhe përljes së madhe, duke hedhur prapa botën dhe ahiretin.

Kurbani i prerë, në emër të flijimit shpirtëror të Ibrahimit (a.s) pas plotësimit të ditëve të caktuara, është një fllad mirësie dhe mëshire që sjell në botën shpirtërore të haxhinjve ndjenjat dhe emocionet e Pejgamberit tonë të madh. Nga gjuhët e atyre që e përjetojnë këtë, derdhen këto fjalë hyjnore që pasqyrohen në Kuran:

**“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, nuk jam nga idhujtarët”!** (el-En’am, 79)

**“Thuaj: Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”** (el-En’am, 162-163)

Hazreti Ibrahim, duke shkuar nga Babilonia për në Egjipt, pati thënë:

“Unë po shkoj te Zoti im. Ai do të më udhëzojë; O Zoti im, dhuromë një fëmijë të mirë!” (es-Saffat, 99-100)

Këtu tregohet për realizimin e një udhëtimi shpirtëror me zemër, për realizimin e udhëtimit përmes botës së brendshme, drejt Krijuesit të Madh.

Në vazhdim të ajeteve Kuranore shpjegohet ngjarja e dhënies së lajmit të mirë të Hz. Ismailit dhe kurhani:

**“Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë!”** (es-Saffat, 101 )

**“Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahim i tha: “O djali im, kam parë në ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti? ” – I biri i tha: “O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!”** (es-Saffat, 102)

**“Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahim) e vuri (Ismailin) me ballë përtokë. Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën” Vërtetë, ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! ”**

(es-Saffat, 103-106)



**“Dhe Ne e zëvendësua atë (Ismailin) me një kurban të madh, dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. Paqja qoftë mbi Ibrahimin”** (es-Saffat, 107-111)

Hz. Ibrahim pasoi pati lënë në Meke Haxheren me Ismailin (a.s), që kthyer pranë Sarës. Herë pas here shkonte edhe pranë tyre. Njëherë, kur ishte në Mekë, pa një ëndërr. Pa në ëndërr, siç tregohet edhe në ajet, se po bënte kurban Ismailin (a.s). Ibrahim (a.s) mendoi rreth ëndrrës. A thua ishte mashtrim nga shejtani, apo urdhër nga Zoti? Mirëpo, e njëjta ëndërr vazhdoi për tre ditë. Këto ditë ishin tevrije<sup>12</sup>, arefe dhe dita e parë e Bajramit në stinën e haxhit.

Në një transmetim rrëfëhet se Ibrahim (a.s) ka thënë:

– Nëse Allahu më jep një djalë, do ta bëj kurban! Ja pra, për këtë fjalë, ai është vënë në provë.

Ibrahimi (a.s) pas urdhrit hyjnor që i erdhi nga Zoti, i tha Haxheres që ta lante djalin, Ismailin dhe ta lyente me erëra të mira, se do ta çonte tek një mik i tij i ngushtë. Ndërsa Hz. Ismailin, pasi e porositi të merrte me vete një pe dhe një thikë, i tha:

– Biri im, ty do të të bëj kurban për hir të Zotit!

Filluan të ecnin drejt vendit ku haxhinjtë qëndrojnë në vakfe në Arafat. Në këtë kohë shejtani,

---

12 **Dita tevrije:** Dita e tetë e muajit Dhu'l-hixhxe, dy ditë para Kurban Bajramit.

me paraqitjen e një njeriu, erdhi pranë Haxheres dhe e pyeti:

– A e di se ku po ta çon Ibrahimimi djalin tënd?

Ajo iu përgjigj:

– Po e çon tek miku i tij i ngushtë.

Ndërsa shejtani i tha:

– Jo, po e çon ta presë.

Haxherja ia ktheu:

– Ai e do shumë djalin e vet!

Kur shejtani tha në vazhdim:

– Do ta presë, sepse e paska urdhëruar Allahu! – Haxherja i tha:

– Nëse Allahu e ka urdhëruar, është një gjë e bukur. Ia lëmë në dorë Atij.

Shejtani, duke mos arritur ta mashtrojë Haxheren, iku pranë Ismailit (a.s) dhe e pyeti:

– A e di se ku po të çon babai yt?

Ismaili (a.s) i tha:

– Të çojë në vend urdhrin e Zotit.

Shejtani u përpoq ta bënte merak duke i thënë:

– Ti e di që ai po të çon të të bëjë kurban.

Më pas Ismaili (a.s) e largoi shejtanin duke i thënë:



– Shporru që këtej i paudhë! Ne me shumë dëshirë e çojmë në vend urdhrin e Zotit. Pastaj e gjuajti atë me gurë.

Kur Shejtani nuk arriti ta mashtrojë as Ismailin (a.s), iu drejtua Ibrahimit (a.s) duke i thënë:

– O i moshuar! Ku po e çon birin tënd? Shejtani të paska mashtruar në ëndrrën tënde! Ato janë ëndrrat e shejtanit.

Ibrahimi (a.s) i tha:

– Ti je shejtani! Largohu menjëherë prej nesh.

Dhe mori në duar shtatë gurë dhe filloi ta gjuante shejtanin në tre vende të ndryshme.

Ja pra, këtu zë fill gjuajtja e shejtanit me gurë, një rit fetar simbolik që vazhdon të bëhet në haxh dhe që do të vazhdojë të bëhet deri në kijamet. Kjo situatë u bë shembull për ummeti Muhamedin, i Cili i kujtoi gjithmonë me përvulje.

Kur Ibrahimi (a.s) kaloi bashkë me Ismailin (a.s) nga Mina për në Arafat, ëngjëjt në qiell ishin mjaft të emocionuar. Ata i thanë njëri – tjetrit me habi:

– Subhanallah! Një peygamber po çon të bëjë kurban një peygamber.

Ibrahimi (a.s) i tregoi të birit Ismailit (a.s) të vërtetën. Ai i tha kështu:

– O biri im, unë jam urdhëruar në ëndrrën time të të bëj kurban.

Ismaili (a.s) pyeti:



– Baba, Allahu ta urdhëroi ty këtë?

Ibrahimi (a.s) tha:

– Po!

Pas kësaj Ismaili (a.s) i tha:

– I dashuri atë! Meqenëse është kështu, ti bëj atë për të cilën je urdhëruar! Nëse dëshiron Zoti, mua do të më kesh të durueshëm.

Ai tregoi se ishte gati të jepte shpirtin. Në atë kohë Ismaili (a.s) mund të ishte vetëm shtatë ose trembëdhjetë vjeç.

Sipas transmetimit, një nga tre vendet ku Xhebraili (a.s) u emocionua dhe pati vështirësi në realizim, ishte momenti kur Ibrahimi (a.s) i vendosi thikën në fyt Ismailit (a.s.) për ta bërë kurban. Si rezultat i përluljeve të tyre ndaj Drejtësisë së Lartë, Ai i njoftoi se do të bënte kurban një dash të sjellë nga parajsja si dhunti hyjnore. Mes thirrjeve të tekбирëve shpirtërorë ai dash u bë kurban.

Qëllimi kryesor i prerjes së kurbanit është të kujtuarit e këtyre ngjarjeve, marrja mësim nga mirësitë e tyre hyjnore dhe forcimi i shpirtit me robërinë ndaj Allahut, me përluljen dhe devotshmërinë ndaj Tij. Ai thotë:

**“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj ...”** (el-Haxh, 37)

Nga ana tjetër, pas prerjes së kurbanit në haxh, një efekt të veçantë ka edhe prerja e flokëve. Përpara Islamit, kur dikush e linte robin e tij të lirë, ia rruante flokët me brisk dhe kjo ishte shenja dalluese e robërisë. Edhe haxhinjtë me rruajtjen në



haxh, pranojnë dhe pohojnë robërinë e tyre ndaj Krijuesit të Lartë. Pra, kjo rruajtje, në një farë kuptimi, është shprehje e një lidhjeje që pasqyron përkushtimin tonë ndaj Allahut dhe të qenurin tonë një rob që i është dorëzuar Atij.

## MINA DHE GODITJA E SHEJTANIT ME GURË

**Mina** në të cilën Hz. Ibrahimimi dhe Hz. Ismaili gjuajtën shejtanin dhe fituan ndaj tij, është një vend i madhërueshëm që vë në dukje faktin se robi në çdo pozicion, duhet të jetojë me ndjenjat e përljes dhe të bindjes ndaj Zotit.

Ndërsa **goditja e shejtanit me gurë** fillon me goditjen e shejtanit që kemi brenda vetes sonë. Siç e shprehëm edhe më parë, shejtani shkoi pas Hz. Ibrahimit, Hz. Ismailit dhe Haxheres që mos t'i linte të qetë. Edhe goditja e shejtanit me gurë që është një nga vaxhibet<sup>13</sup> e haxhit, është një kujtim i goditjes me gurë të shejtanit dhe i largimit nga ai.

Goditja me gurë, në një farë mënyre, ka kuptimin e mallkimit që i bëhet shejtanit, pasi në atë kohë mallkimi bëhej me gjuajtjen me gurë.

Duhet theksuar se edhe guri i hedhur, i marrë nga toka, nga aspekti i formës, është guri i hedhur ndaj gjynahut.

---

13 **Vaxhib:** Obligim jo në shkallën e farzit.

Qëllimi është të mbërrihet tek krijuesi. Pejgamberi (a.s) ka urdhëruar: *“Të gjuash me gurë shejtanin dhe të ecësh mes Safas dhe Merves është urdhëruar vetëm për të adhuruar Allahun”* (Tirmidhi, Haxhxh, 64/902)

Gjithashtu qëllimi tjetër i gjuajtjes së shejtanit me gurë është urrejtja për të, sepse ai e nënvlerësoi Hz. Ademin, ngaqë ishte krijuar nga dheu dhe u bë mendjemadh, për shkak se ishte krijuar nga zjarri. Prandaj, edhe Allahu i Lartë obligoi gjuajtjen e tij me gurë, në formën e këtij dheu që ai e nënvlerësoi.

Kështu, përpikmëria dhe vetëdija që duhet arritur duke goditur shejtanin me gurë, duhet të përfshijë tërë jetën tonë. Çdo ngatërresë që shejtani na pëshpërit në zemër, duhet ta shmangim me anë të shprehjes:

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

**“I mbështetem Allahut nga e keqja e shejtanit të mallkuar”** Në këtë mënyrë deri në frymën e fundit, në çdo moment, duhet ta godasim shejtanin. Allahu thotë:

**“Nëse djalli fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu !..”** (Fussilet, 36)

Si përfundim, goditja me gurë e shejtanit është mallkimi i iblisit dhe drejtimi drejt Allahut, në mënyrë krejt të vetvetishme.

Gjatë haxhit dhe umres nuk duhet të largojmë nga mendja faktin se hajdutët, nuk mundohen të hyjnë në dyqane të vjetra, kur ka dyqane argjendarie. Meqë pasuria gjendet në dyqanet e argjendarisë, ku ka mallra me vlerë, edhe një besimtar i përkushtuar ndaj adhurimit me një njeri që qëndron me vetëdije larg adhurimeve, i ngjan këtij krahasimi. Shejtani që ka marrë leje nga Krijuesi i Lartë për të shkatërruar njerëzimin, vrapon më shumë pas atij që adhuron. Prandaj personin që e ka bërë nijet haxhin dhe umrenë, e zë belaja më shpejt. Për këtë arsye, ata që shkojnë në haxh, si armë të parë duhet të rrokin durimin, pasi haxhi është ndryshe nga ritet e tjera fetare. Nga ana e jashtme, të duket diçka e lehtë, por në fakt është një nga ritet më të vështira. Kjo është edhe arsyeja që kur bëhet nijeti, thuhet edhe:

– Zoti im! Ma lehtëso mua atë!..

Shpirtrat që gjejnë mbështetje tek Zoti thonë:

لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ  
 إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ

Të gjithë e dinë se kur pranojnë ftesën e Zotit të tyre, si dhe faktin që nuk ka Zot tjetër veç Tij, duhet të japin fjalën se nuk do t'u drejtohen më epsheve, shejtanit dhe dëshirave vetjake.

Për këtë arsye, ajo që duhet të bëjë besimtari është të mundohet të jetë i zgjuar ndaj çdo lloj kurthi të shejtanit. Gjithashtu, gjatë këtij udhëtimit të



vështirë duhet të ketë kujdes të mos dëmtojë anën shpirtërore të adhurimeve në haxh dhe umre, të mos mposhtet dhe të durojë duke menduar se të gjitha këto janë prova.

### KODRA MERVE, SAFA DHE RITI “SA’J”<sup>14</sup>

**Kodrat Safa dhe Merve** janë dy kodra të madhërueshme ku gjendet sot burimi Zemzem. Aty, nëna e Hz. Ismailit, Hz. Haxherja shkante e vinte me hall dhe emocion të madh për të gjetur ujë të pijshëm për të birin, të cilit i kishte rënë të fikët nga etja. Për këtë arsye vajtja dhe ardhja mes Safasë dhe Mervesë mbart mirësinë e të mbështeturit të njeriut tek Zoti me një pendim tepër të madh. Prandaj, edhe mes bazave të haxhit është shtuar edhe riti i quajtur **sa’j**.

Allahu e shpreh kështu rëndësinë e këtyre dy kodrave:

إِنَّ الصَّفَاَ وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ

**“Padyshim Merve dhe Safa janë nga shenjat e Allahut... ”** (el-Bakare, 158)

Edhe përsa i përket faktit se si duhet të sillen besimtarët ndaj dispozitave të Allahut, përsëri Zoti ynë urdhëron:

14 **Riti sa’j**: Katër vajtjet dhe tre ardhjet që bëhen mes kodrave Safa dhe Merve gjatë ibadetit të haxhit ose të umres.



**“...Ndërsa kush madhëron dispozitat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij”**  
(el-Haxh, 32)

## **QABJA MADHESHTORE**

Qabja që është kibla e besimtarëve, është qëllimi i drejtimit të namazit, të cilin Allahu i Lartë e urdhëroi në Kuran me shprehjen “...bëj sexhde dhe afrohu!” (el-Alak, 19). Gjithashtu Qabja është vendi ku drejtohen të gjithë myslimanët e botës, pra vendi ku bota Islame mat pulsën e vet.

Ashtu sikurse pasqyra e syrit hyjnor tek njeriu është zemra, po ashtu edhe pasqyra e gjithësisë është Qabja. Pra Qabja në gjithësi, në një farë mënyre, mund të mendohet si zemra në trupin e njeriut. Për këtë arsye haxhi është një adhurim që duhet bërë me zemër, duke kuptuar madhësinë e Qabes.

Fakti që Qabja cilësohet si shtëpia e Allahut, tregon se është një faltore e shenjtë që prej Ademit (a.s) dhe se vizita tek Ajo është bërë farz për ata që kanë mundësi. Në ajetet Kuranore njoftohet kështu:

**“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Mekë, e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.**

**Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (makami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurtë; dhe vizita (për haxh) e kësaj fal-**

**toreje** (e cila është detyrë) **për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd**” (Al-i Imran, 96-97)

Në Qaben madhështore ndodhet **“Makami i Ibrahimit (a.s.)”** Allahu i ka ngarkuar besimtarët që kanë mundësi për haxh apo umre, detyrën e të ecurit në vendin e shenjtë, në vendin ku gjendet gjurma e këmbës së tij, Ibrahimit (a.s), si dhe të falin namazin e tavafit, mbas postit të tij.

Edhe **“Haxheru’l-Esved”** që përshëndetet dhe uthet me respekt në Qabe, është një gur i madhërueshëm, është vendi ku i jepet fjala për përulje dhe robëri Atij. Të përshëndesësh Atë, do të thotë të japësh fjalën se do të heqësh dorë nga të gjitha përuljet shpirtërore dhe drejtimet që të jep shejtani.

Haxheru’l-Esved është një pikë referimi e fillimit dhe e mbarimit të tavafit. Deri tani pothuajse çdo gur i Qabes ka ndryshuar, por Haxheru’l-Esved ka ardhur deri në ditët tona pa ndryshuar. Sa e sa pejgamberë me në krye Muhamedin (a.s) e kanë puthur dhe sa e sa duar të madhërueshme e kanë prekur. Kështu që ai nga një gur i thjeshtë, është bërë tashmë një kujtim dhe një gonxhe krejtësisht tjetër në zemrat tona.

Shkurtimisht, Qabja me të gjitha të veçantat e Sa’jit, thuajse është një hije e Fronit Hyjnor në tokë, një burim mëshire dhe mirësie. E thënë ndryshe, Ajo është një pasqyrë e shndritshme që rrezaton cilësitë e mëshirës dhe të faljes së Alla-

hut. Ajo është një diell që ndriçon shpirtrat, një burim drite.

Sipas transmetimit në lidhje me ndërtimin e Qabes, Hz. Ademi me Hz. Havanë, në kohën që u nxorën nga xheneti, u takuan në Arafat, ecën së bashku drejt Perëndimit dhe erdhën në vendin ku gjendet Qabja. Në këtë kohë, Ademi (a.s) deshi të adhuronte Zotin për ta falenderuar për këtë takim dhe iu lut Atij që t'i jepte përsëri kollonën e ndritshme për të bërë ibadet, duke bërë tavaf rreth saj, duke qenë në xhenet. Pikërisht aty zbriti kollona e dritës dhe Hz. Ademi adhuroi Allahun duke bërë tavaf rreth saj.

Kjo kollonë prej drite humbi në kohën e Hz. Shitit dhe në vend të saj mbeti një gur i zi. Më pas Hazreti Shiti bëri një ndërtesë prej guri me katër qoshe. Si atë dhe gurin e zi e vendosi në një qoshe të ndërtesës. Ja pra, ai që sot njihet si **Haxheru'l-Esved**, është pikërisht guri i zi.

Më pas, kjo ndërtesë mbeti e fshehur poshtë rërës për një kohë të gjatë. Hazreti Ibrahim i me urdhrin e Allahut erdhi në vendin ku ndodhet Qabja, dhe të birin Ismailin (a.s) e vendosi aty së bashku me nënën e tij. Më pas së bashku me Ismailin (a.s) kur i erdhi urdhri i Allahut, hapi vendin ku ndodhej Qabja. Gjeti themelet e ndërtesës së bërë nga ana e Hazreti Shitit dhe mbi ato themele ndërtoi Qaben madhështore.

Dhe kur përfundoi Qabja, Ibrahim (a.s.), iu lut Allahut :



**“... Zoti Im! Bëje këtë vend qytet të sigurtë dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!..”** (el-Bakara, 126)

Si një begati e kësaj lutjeje të Ibrahimit (a.s) në Mekë është përputhja e ëmbëlsisë së gojës me atë të besimit.

Ndërtimi i Qabes është bërë rreth njëmbëdhjetë herë.

Hera e parë nga ana e ëngjëjve, hera e dytë nga ana e Ademit (a.s), hera e tretë nga ana e Shitit (a.s), hera e katërt nga ana e Ibrahimit (a.s), hera e pestë nga ana e fisit Amalika, hera e gjashtë nga ana e Xhurhumive, hera e shtatë nga ana e Kusajt, hera e tetë nga ana e Kurejshit, hera e nëntë nga ana e Abdullah bin Zubejrit prej tabiinve<sup>15</sup>, hera e dhjetë nga ana e Haxhxhaxh-i Dhalimit dhe hera e njëmbëdhjetë nga ana e sulltanit Murat Han IV të Perandorisë Osmane.

Perandoria Osmane ka treguar kujdes dhe respekt të madh ndaj Qabes Madhështore. Kjo është vënë re edhe gjatë riparimit, p.sh.

Në kohën e Muratit IV ndodhi një përmbytje dhe të dy anët e Qabes u çanë. Pas kësaj ngjarjeje u dërgua menjëherë, për riparim në Mekë, kryearkitekti Ridvan Aga. Ai, pasi bëri përcaktimet e nevojshme duke treguar vendet e dëmtuara, e gjykoi si mosrespekt ndaj Qabes Madhështore

<sup>15</sup> **Tabiin:** Gjenerata që vjen pas asaj të Muhamedit (a.s.)

përdorimin e termave të tillë si “shëmbje dhe çarje” dhe përdori një shprehje të tillë:

**“Këto pjesë të shtëpisë së Zotit kanë një përkulje të pjesshme.”**

Edhe gjatë riparimit është treguar kujdes i madh që është dukur qartë në marrjen e disa masave, me qëllim që ato vende të madhërueshme të mos ndoteshin nga kafshët që mbartnin materialet e nevojshme për ndërtim.

### **PARA SE TE TE TROKASE EXHELI<sup>16</sup>...**

Nuk duhet të harrojmë se jeta i dhurohet njeriut vetëm një herë. Edhe vdekja është një ligj i pandryshueshëm i Allahut, i caktuar për të gjithë të vdekshmit. Afati i kohës, minutit dhe sasia e frymëmarrjes është e përcaktuar. Moslëvizja parambrapa e exhelit është një e vërtetë e qartë, që nuk mund të merret pak para e as që mund të shtyhet pak prapa. Gjithashtu nuk ka ndodhur ndonjëherë të ketë shpëtuar ndonjëri nga çasti i fundit.

Prandaj, ata që janë të obliguar për haxh, duhet t’i mendojnë mirë këto të vërteta dhe të bëjnë kujdes të veçantë që të mos tregojnë shkujdesje e neglizhencë ndaj këtij ibadeti të madh, sepse kur t’i vijë fundi jetës, nuk ka vlerë pendimi. Atëherë, për të qenë të vëmendshëm ndaj Zotit, duhet ta kryejmë këtë hua që i kemi Krijuesit tonë, sapo

16 **Exhel:** Çasti i fundit i jetës së njeriut.

të na jepet mundësia, përndryshe, paralajmërimi i Hz. Pejgamberit (s.a.s.), është i tmerrshëm dhe i frikshëm:

*“Çdokush që i ka të ardhurat e mjaftueshme për të ngënë, për të pirë dhe për udhëtim, (kur i ka mundësitë), nëse nuk bën haxh në Bejtullah<sup>17</sup>, nuk e pengon asgjë që të vdesë si i krishterë apo si hebre!”* (Tirmidhi, Haxh, 3)

Ky paralajmërim profetik tregon se do jenë në një humbje të llahtarshme ata që duke i pasur të gjitha mundësitë për të bërë haxhin, e neglizhojnë këtë ibadet. Kështu që ky neglizhim çon në një gabim.

Kryerja e haxhit një herë në jetë është farz për çdo besimtar që i ka mundësitë. Përsëritja e haxhit herë pas here është mustehab<sup>18</sup> dhe ka plot sevape.

Prandaj, edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë kështu:

*“Kryerja e haxhit dhe e umres njëra pas tjetrës, shton jetën dhe rriskun dhe largon varfërinë dhe gjynahin, ashtu siç gjyryku e heq ndryshkun nga hekuri.”* (Ahmed b. Hanbel, III, 446-447)

Përsëri në një hadith kudsii thuhet kështu:

*“Allahu i Madhëruar thotë kështu:”Nëse një robit tim, Unë i kam dhënë plot shëndet dhe pasuri, por ai nuk*

17 **Bejtullah:** Shtëpia e Allahut, Qabja.

18 **Mustehab:** e pëlqyeshme.

*vjen tek Unë, një herë në katër vjet, atëherë ai njeri është me të vërtetë një njeri varfanjak.”* (Hejthemi, III, 206)

Ashtu siç kanë nafile ibadetet e tjera farz, si: namazi dhe agjërimi; edhe haxhi ka nafilen e vet. Kritikata idiotheske të bëra ndaj ibadetit të haxhit nafile, Allahu na ruajt, janë ato fjalë që anojnë drejt blasfemisë. Këto janë mendime të pabaza, janë shprehje të liga, të dala nga ata që u mungon shija e besimit dhe e ibadetit.

Që nga asr-i saadet, ibadetet nafile janë praktikuar me një dashuri të madhe. Na mjafton si she-mbull, po të kujtojmë se Imam Adhami ka bërë 55 herë haxh. Hz. Imam Adhami, Ebu Hanifja megjithëse ka pasur shumë studentë dhe ka qenë i zënë me shumë punë, e ka ndarë afërsisht një të tretën e kohës së tij për kryerjen e haxhit. Duke pasur para sysh kushtet e kohës, duhet të imagjinojmë se sa i mundimshëm ishte udhëtimi me deve nga Bagdati në Meke Mukerreme<sup>19</sup> dhe Medine Munevvere<sup>20</sup>. Por, njerëzit e veçantë të Zotit e kanë konsideruar si një dhunti të madhe shkuarjen në haxh dhe vizitën te i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Ato shfrytëzonin çdo mundësi që u jepej, ngaqë e kishin kuptuar se në asnjë vend tjetër nuk do të gjenin atë përfitim shpirtëror që kishin në klimën frymëzuese të Haramejnëve.

Prandaj, ibadetet nafile që kryhen në një atmosferë besimi të madh, bëhen shkak ta afrojnë robin tek Allahu. Shpirtrat njerëzorë zgjerohen.

19 **Mukerreme:** e nderuar.

20 **Munevvere:** e ndritur, e përndritshme.

Atëherë Allahu i Madhëruar i bëhet syri që shikon dhe veshi që dëgjon besimtarit të tillë. Pra, vështrimi, dëgjimi, meditimi dhe shprehja e tyre bëhen përherë rreze e dritës hyjnore.

## TEVEKKULI DHE TESLIMIJETI

Haxhi për arsye të natyrës së tij, e drejton njeriun nga delikatesë shpirtërore. Kështu edhe Bejtullahu është një vend i mbushur me mbresa të **tevekkulit** dhe **teslimijetit** të Ibrahimit (a.s.), dhe familjes së tij. Kur përmenden fjalët tevekkul, teslimijet dhe haxh na shkon mendja tek Ibrahim (a.s.) dhe Ismaili (a.s.). Prandaj, haxhi për arsye të shumë kushteve që ka, është një ameli salih<sup>21</sup>, sepse me begatinë e sinqeritetit përsëritet deri në ditën e kijametit.

**Tevekkuli** sipas kuptimit etimologjik do të thotë “të rezistosh, të besosh, të mbash një përfaqësues dhe t’i besosh përfaqësuesit”. Ndërsa, sipas tasavvufit, tevekkul do të thotë besimi dhe mbështetja vetëm tek Allahu e atij që zemrën e ka të mbushur me Allahun.

Zoti i Madhëruar e pat pyetur Musain (a.s.), për shkopin që mbante në dorë, pastaj e pat urdhëruar: **“Hidhe atë nga dora”**, sepse shkopi po ia linte njeriut në hije tevekkulin që kishte ndaj Zotit.

21 **Ameli salih**: vepër e mirë, vepër e dobishme, vepër që e pëlqen Allahu i Madhëruar, ibadet.



Kështu, në versetet Kuranore thuhet:

**“...Besimtarët le t’i mbështeten vetëm Allahu”** (Ibrahim, 11; et-Tevbe, 51)

**“...Vetëm All-llahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë”** (Maide, 23)

**“...Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij”** (et-Talak, 3)

Ndërsa në hadith thuhet:

*“Sikur ju të bëni tevekkul si duhet, do ushqeheshit si zogjtë që në mëngjes dalin të uritur dhe kthehen të ngopur në mbrëmje!”* (Tirmidhiu, Zuhd, 33)

Tevekkuli nuk është të përjashtosh maturinë dhe përpjekjen, përkundrazi tevekkuli është të mbështetesh tek Allahu, pa i mënjeluar ato.

**“...Këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai ”** (Ali Imran, 159)

Ndihmësi i besimtarëve në të dy botët është Allahu. Ai i mjafton atyre që i mbështeten. Si nga aspekti individual, ashtu edhe nga ai social, prehja dhe lumturia e vërtetë është vetëm tek kthimi nga Allahu, është tek ndihma dhe mbështetja e Tij.

**Teslimijet** rrjedh nga fjala **سَلِمَ**, e cila ka kuptimin të nënshtrohesh, të pranosh ndodhitë pa u ankuar dhe të arrish lumturinë.



Në zemrën e Ibrahimit (a.s.), nuk kishte vend për asgjë tjetër, përveç Allahut. Prandaj, edhe Zoti i Madhëruar e kishte bërë atë Halil, mik.

Ëngjëjt i patën thënë:

-O Zot! Ibrahim i ka shpirt, fëmi dhe pasuri. Si mund të bëhet Halil për Ty?!

Dhe Allahu i Madhëruar u pat treguar teslimijetin e tij pa ankesë, në tre raste. Këto sprova dhe pasojat e tyre do të jenë shembull për ymetin deri në ditën e kijametit.

Ibrahimit (a.s.), kur do hidhej në zjarr, i patën ardhur në ndihmë ëngjëjt, mirëpo ai u pat thënë duke iu mbështetur Zotit:

- Nuk kam nevojë për ju!.. Kush i ka dhënë fuqinë e të djegurit zjarrit? Sa vekil<sup>22</sup> i mirë që është Allahu!”

Si një shpërblim për këtë teslimijet të tij, iu pat thënë zjarrit:

**“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”** (el-Enbija, 69)

Edhe pasuria në syrin e Ibrahimit (a.s.), ishte e parëndësishme, pasi Xhebraili (a.s.), i pat kujtuar tre herë Zotin e Madhëruar dhe i pat thënë:

- Merri të gjitha këto!

Përsëri Ibrahim i (a.s.), është sprovuar me flijimin e djalit të tij dhe me ndihmën e teslimijetit që

<sup>22</sup> **Vekil:** Në këtë rast është me kuptimin “Ai që meriton t’i besohet”.

pat treguar ndaj urdhrin të Zotit të Madhëruar, e pat kaluar këtë sprovë faqebardhë.

Ja pra, besimi i vërtetë është teslimijeti, sepse Allahu, xhel'le xhelaluhu, nuk dëshiron përruljen nga askush tjetër, përveçse nga besimtari i tij.

Teslimijeti është bindja e mbështetur në dashuri. Me begatinë e kësaj bindjeje dhe të këtij teslimijeti të Ibrahimit, alejhi's selam, jeta, pasuria dhe fëmija nuk u bënë aspak pengesë për në rrugën e Zotit të Madhëruar. Edhe ibadeti i haxhit u bë simboli më i bukur i tevekkulit dhe teslimijetit që tregoi ai ndaj Zotit, ibadet i cili do vazhdojë gjër në kijamet, sepse gjuha e Ibrahimit (a.s.), duke bërë përkthimin e zemrës, thoshte përherë:

**“ I jam dorëzuar Zotit të gjithësisë!”** (el-Bekare, 131)

Haxhi që është simboli i tevekkulit dhe i teslimijetit të Hazreti Ibrahimit dhe Hazreti Ismailit, alejhima's-selam, është një hyrje e veçorive njerëzore në klimën e mëshirës: tevekkul dhe teslimijet.

Ja pra, edhe ibadeti i haxhit na tregon se derdhja e gjynaheve bëhet me begatinë e ibadeteve që kryhen me një zemër të mbushur me nënshtrim, tevekkul dhe teslimijet.

Nga krahu tjetër, ata që dalin për haxh dhe umre duhet ta kuptojnë drejt tevekkulin dhe teslimijetin, duhet t'i bëjnë mirë përgatitjet materiale dhe shpirtërore, sepse disa njerëz nga populli jemenas thonin: “Ne i jemi dorëzuar Allahut!” pa qenë të përgatitur për rrugën dhe kur arrinin në

Meke, dilnin për të lypur nga uria. Për këtë ngjarje, pat zbritur ky ajet Kuranor:

**“...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria...”** (el-Bekare, 197)

Ashtu siç mund të kuptohet edhe nga ajeti, në ato vende të shenjta është i nevojshëm furnizimi material dhe ai shpirtëror. Kjo, normalisht realizohet vetëm me një zemër të shëndoshë që ka arritur në “devotshmëri”. Sepse një nga qëllimet më të natyrshme të edukimit me moralin e Allahut, është pajisja me një zemër të mbushur me refleksione të devocionit.

## MASAT SHPIRTËRORE PËR NJË HAXH DHE UMRE TË PRANUESHME.

Masat kryesore që duhen bërë kujdes për një haxh dhe umre të pranueshme tek Allahu janë këto:

### 1. Ta bësh nijet me sinqeritet haxhin dhe umren, si dhe të heqësh dorë nga nijetet dhe sjelljet e kundërta me të:

Që të meritojmë pëlqimin e Zotit të Madhëruar dhe të përfitojmë nga dhuntitë hyjnore, duhet të bëjmë nijet me sinqeritet të plotë dhe ndërkohë që i japim fjalën Allahut të Madhëruar, duhet të vendosim vulën e refuzimit të marrëveshjeve epshore dhe dobësive njerëzore

që kanë zënë vend brenda nesh. Në ato vende të shenjta, duhet ta mbyllim librin e ekzistencës dhe të distancohemi nga epshi. Pra, ata që i drejtohen haxhit dhe umres me këtë ndjenjë, bëhen mysafirë të sarajit të sekreteve dhe urtësive hyjnore duke kaluar nga porta e meritës së mëshirës dhe begatisë së Zotit. Pas kësaj etape ata detyrohen për këtë:

## **2. Kur të heqësh rrobat për të veshur ihramin, të heqësh dhe rrobat e të qenurit krijesë:**

Për ihramin jo vetëm që duhet të heqim mbulesën e sipërme, që është një shfaqje e sinqeritetit dhe e paktit shpirtëror, të bërë për haxh dhe umre për hir të Zotit, por duhet të zhvishemi edhe nga pasionet e botës sonë të brendshme, si: të qenurit i pasur, të qenurit i famshëm, të qenurit në pozitë dhe pastaj të vishemi me rrobën e devocionit, sepse Allahu ka thënë:

**“Ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten.”** (Esh-Shems, 9)

Duhet ta lidhim zemrën me Allahun në klimën e shenjtë dhe duhet të ruhem në mosmerrme me punët e kësaj bote dhe përveç rasteve të nevojshme, të mos shëtisim nëpër pazare, sepse duke u zhytur në punë të tilla, shfaqet një shkujdesje dhe moskokëçarje dhe kështu vështrësohet përfitimi nga klima shpirtërore e atyre vendeve të begata.

I dërguari i Allahut (s.a.s.) u ka thënë atyre që pyesnin lidhur me qëndrimin në Meke, pasi të kryenin haxhin:

*“Mekeja nuk është vendbanim. (Vetëm) tri ditë duhet qëndruar në Meke pasi kryhet haxhi nga njerëzit e ardhur prej jashtë.”* (Ahmed bin Hanbel, IV, 339).

Hazreti Umeri, radijall’llahu anh, i ka këshilluar ata që kryejnë ibadetin e haxhit dhe umres, që të kthehen menjëherë në vendin e tyre, me qëllim që të mos prishen ndjenjat madhështore dhe të mos fillojë pafytyrësia.

Kur jemi në haxh dhe umre duhet t’i drejtohem Zotit të Qabes dhe të kuptojmë se **“...Ai është pranë robërve të Tij se damari i qafës së tij”** (Kaf, 16). Përsëri ashtu siç thotë ky ajet fisnik **“...All-llahu ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij...”** (el-Enfal, 24), duhet të jemi të vetëdijshëm se asgjë nuk mund të jetë e panjohur nga Ai. Pra, të shmangemi nga dashuritë tokësore, të përkohshme dhe të bëjmë kujdes që zemra jonë të jetë me Zotin, sepse esenca e haxhit dhe umres është kjo:

### 3. Pastrimi nga aspekti material dhe ai shpirtëror:

I dërguari i Allahut (s.a.s.), kur shpjegon konkluzionin e veprave të mira të bëra gjatë kohës së haxhit dhe umres, në një mënyrë edhe qëllimin e këtyre ibadeteve, thotë kështu:

*“Bashkoheni kohën e haxhit me të umresë, sepse këto e pastrojnë gjynahin ashtu siç e pastron gjyry-*

*ku ndryshkun në hekur.”* (Nesai, Menasik, 6; Ibn Maxhe, Menasik, 3)

Ja pra sa i rëndësishëm është ibadeti i “umres”, i cili u këshillua në hadith me fjalët: “Bashkojeni kohën e haxhit me umren”. Ai është shkak për një pastrim shpirtëror, për ripërtëritje dhe rifreskim të besimit.

“Umre”, bëhet një herë në vit dhe jashtë ditëve të caktuara për haxhin, në cilëndo kohë dhe sa ditë që dëshiron. Për arsye të vlerës së lartë që ka, është quajtur edhe “haxhi i vogël”. Vlera e këtij ibadeti duhet perceptuar mirë.

Kur Umeri i kërkoi leje për Umre profetit (a.s.), Ai i tha:

*“Vëlla i dashur, na bëj pjesëtar edhe ne në lutjen tënde, mos na harro!”* (Tirmidhi, Deavat, 109/3562)

Hz. Umeri, radijall’llahu anih, situatën që pat ndier në ato momente e pat thënë kështu:

*“Sikur të më jepnin botën në këmbim të kësaj fjale të Profetit (s.a.s.), nuk do të gëzohesha kaq shumë.”* (Ebu Davud, Vitri, 23/1498)

Ja pra ky shembull, bashkë me urtësitë e tjera, tregon se lutjet e bëra në ibadetin e umres, në krahasim me kohët e tjera, janë më të pranuar. Kjo do të thotë se lutjet e sinqerta të bëra gjatë ibadetit të umres kanë një shpërblim të madh.

Umret e bëra pas haxhit dhe në veçanti ato që bëhen pas Ramazanit, janë mënyrat më të begata për t’u pastruar shpirtërisht. Gjithashtu

Profeti, alejhi's-salatu ve's-selam, në porosinë e tij ka thënë se një umre e bërë në Ramazan është si një haxh i bërë së bashku me të. (Buhari, Umre, 4; Muslimi, Haxh, 221)

Ja pra, përderisa qëllimi i ibadetit të haxhit dhe umres është pastrimi shpirtëror dhe të merituarit e një shpërblimi kaq madhështor, padyshim që një tjetër çështje që duhet të bëhet kujdes dhe t'i jepet rëndësi nga udhëtarët e Hixhazit<sup>23</sup> është:

#### **4. Të hysh me edukatë në Haremin Sherif<sup>24</sup> dhe të nderosh simbolet fetare, pasi të kesh braktisur të ndaluarat dhe dyshimet:**

Pikësëpari, të gjithë ibadetet dhe veprat e mira duhen bërë me fitime prej hallalli, sepse begatia e ibadetit bëhet e mundur me furnizimin prej hallalli që i bëhet trupit. Kjo porosi profetike është shumë mësimdhënëse, sepse tregon rëndësinë e fitesës hallall, sidomos gjatë ibadetit të haxhit dhe umres:

*“Kush e viziton këtë Shtëpi me paratë që i ka fituar në mënyrë të ndaluar, ka devijuar nga nënshtrimi ndaj Allahut. Një njeriu të tillë që vendos të bëjë haxh, të veshë ihramin, të hipë dhe të lëvizë devenë e tij, kur thotë: “Lebbejk All'illahumme lebbejk”<sup>25</sup>, nga lart i vjen një zë që i thotë:*

23 **Hixhaz:** Zona e Mekes dhe Medines.

24 **Haremi Sherif:** Ambjenti përreth Qabes.

25 **Lebbejk All'illahumme lebbejk:** “Allahu im, Ty t'u nënshtrova!” ose “Urdhëro, Allahu im!”




*“Për ty nuk ka as lebbejk e as sa’dejk! Sepse ti e ke fitesën haram, furnizimin haram dhe kafshën haram. Kthehu mbrapsh pa marrë asnjë sevap! Mërzitu ngaqë do përballësh me diçka që nuk do të pëlqejë!”*

*Ndërsa ai që nis rrugën e haxhit me para hallallit, kur hip në kafshë, dhe bën të lëvizë devenë e tij, nëse thotë: “Lebbejk All’lhamme lebbejk”, nga lart, një zë i përgjigjet:*

*“Lebbejk dhe sa’dejk! Ty po të përgjigjem, sepse ti e ke prej hallalli kafshën, rrobën dhe furnizimin. Kthehu me plot sevape të mëdha dhe si të mos kesh bërë gjynahe fare. Gëzohu, pasi do takohesh me gjëra që do të kënaqin e do të gëzojnë.”* (Hejthemi, III, 209-210)

Sipas hadithit, ata që në haxh thonë vetëm me gojë “lebbejk”, është e qartë se nuk do kenë përfitim tjetër përveç shprehjes “La lebbejk”.

Prandaj, kushti i parë për haxh është fitesa prej hallallit dhe pastaj, një shpirt i sinqertë... Çdo “Lebbejk”, pra, çdo shprehje “Urdhëro Allahu im! Jam i dorëzuar dhe i gatshëm për urdhrin Tënd” e derdhur nga goja duhet të jetë me një ngrohtësi dhe me një pasion që ta djeg zemrën me dashuri. Thirrjet “Lebbejk” që dalin nga një zemër e tillë afrojnë robin tek Zoti. Por, fjalët e thata dhe të zbrazëta nuk kanë asnjë farë vlere. Në kontekst me këtë, nipi i Pejgamberit, Hazreti Husejni, radijall’llahu anh, kur thoshte “lebbejk”, zverdhej nga shqetësimi, duke thënë:

– Po sikur përgjigja që do marr të jetë “La lebbejk”?!  


Gjatë haxhit janë disa akte të ndaluara, ndaj të cilave duhet treguar kujdes i veçantë. Zoti i Madhëruar thotë kështu:

**“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur. ”** (el-Bekare, 197)

Lidhur me këto, **“refes<sup>26</sup>, fusuk<sup>27</sup> dhe xhid<sup>28</sup>”**, pasionet e shprehura, përveç ndalesave të njohura si fajet dhe debati, duhet bërë shumë kujdes që të mos i shqetësosh robërit e Zotit, sepse nga fluksi që ka aty, haxhijtë, janë në çdo moment përballë një shqetësimi të mundshëm ndaj besimtarëve. Për t’u ruajtur nga kjo, në veçanti duhet bërë shumë kujdes që të tregohet edukatë dhe xhentilesë gjatë tavafit. Në tavaf, nuk duhet t’i mundojmë besimtarët duke u sjellë në drejtim të kundërt.

Në veçanti, duhet treguar delikatesë ndaj përzierjes burra-gra në turmë dhe në ashensorin e hoteleve të Haremit Sherif, duhet treguar rregull dhe seriozitet në hyrjet. Nuk duhet të harrojmë se aty është e ndaluar të këputet qoftë edhe një fije bari dhe se sjelljet tona njerëzore

26 **Refes:** Marrdhënie intime.

27 **Fusuk:** Mëkate, faje.

28 **Xhid:** Debat.

mund të na afrojnë pranë Zotit, kur janë brenda një atmosfere ibadeti. Prandaj vendin e sjelljeve harbute dhe të vrazhda duhet ta zënë dashuria, mëshira, respekti, mirësjellja dhe delikatesa, sepse nuk duhet harruar se aty, ashtu si shpërblehen me shumëfish veprat e mira, po ashtu ndëshkohesh shumëfish edhe për fajet dhe gjenahet që bën. (Shih. M. Xhemaiddin el-Kasimi, *Zubdetu'l-Ihja*, Istanbul 1969, f. 94.)

Këto lloj delikatesash, janë hollësira të rëndësishme me të cilat ishte i pajisur Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.). Ai ishte shembulli i mëshirës dhe i mirësjelljes.

Pejgamberi (s.a.s.), një ditë iu drejtua Hazreti Umerit, radijall'llahu anhu, duke i thënë:

*“O Umer! Ti je një burrë i fuqishëm. Mos i munda njerëzit për të arritur Haxheru'l-Esvedin<sup>29</sup>! Mos lejo të të shqetësojnë, por as mos i shqetëso të tjerët! Nëse e gjen të lirë rrugën për te Haxheru'l-Esvedi, përshëndete dhe puthe, përndryshe bëji me shenjë nga larg, kalo duke thënë kelimetu't-tevhidin<sup>30</sup> dhe tekbir<sup>31</sup>!”* (Hejthemi, III, 241; Ahmed, I, 28)

Me siguri është reflektimi i kësaj ndjenje që Hazreti Umeri, radijall'llahu anh, një ditë, i drejtohet Qabes dhe i thotë:

29 **Haxheru'l-Esved**: Guri zi i cili ndodhet në njërën prej qosheve të Qabes.

30 **Kelimetu't-Tevhid**: Fjala e Njësisë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i dërguari i Tij.”

31 **Tekbir**: All'llahu ekber! Allahu është më i larti!

*“Sa madhështore që je o Qabe! E lartë është fama jote. Mirëpo, nderi i një besimtari të vërtetë pranë Allahut është më i lartë se ti.”* (Tirmidhi, Birr, 85)

Kështu, bashkë me kujdesin që duhet treguar ndaj të drejtave të njerëzve duke mos i shqetësuar ata, duhet t’i japim shumë rëndësi edhe edukatës së brendshme dhe të jashtme, sepse një nga qëllimet e haxhit dhe umres është ngritja në grada më të larta të zemrave tona, duke respektuar dhe duke u frymëzuar me mbresat e këndshme të atyre vendeve të shenjta. Në versetin Kuranor thuhet:

**“...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.”** (el-Haxhxh, 32)

Sipas kësaj, namazi, mesxhidi, Kurani Famëlartë, ezani, gjithashtu dhe vendet e shenjta si Qabja, kodrinat Safa dhe Merve, janë simbole të Allahut. Në haxh dhe në umre, këto nuk duhen harruar pa u respektuar.

Duhet ruajtur nga sjelljet jo të hijshme si: të zgjasësh këmbët apo të shtrihesh në drejtim të Qabes, të flasësh gjepura, të lexosh Kuranin Famëlartë në mënyrë të paedukatë dhe ta ulësh në mënyra që cenojnë madhësitinë e tij.

Nga ana tjetër, ne na duhet të përpiqemi t’u zgjidhim problemet dhe të kuptojmë gjendjen e vëllezërve tanë besimtarë që janë të sëmurë, të mbetur në rrugë, apo që nuk kanë mundësi të ndryshme, që kanë humbur të afërmit etj... pra, të gjithë ata që janë në gjendje të vështirë. Këto virtyte të larta, si: mëshira dhe altruizmi, në të

njëjtën kohë, janë cilësi që duhet t'i ketë çdo zemër besimtari. Përsëri duhet menduar se aty është vendi i vështrimit hyjnor, prandaj të mos u thyejmë zemrën të tjerëve, përkundrazi, brenda mundësive, të përpiqemi t'ua ngrohim zemrat.

Sa bukur e shpjegon Mevlana, kuddise si-rruh, me këtë tregim se si mund të arrihet me një zemër të ndjeshme tek e vërteta e ibadeteve dhe në veçanti, tek e vërteta e haxhit:

“Bejazid Bestami, njëri nga figurat e larta të ymetit, po shpejtonte të shkonte në Meke për haxh dhe umre. Në çdo vend që shkonte, kërkonte besimtarët e vendit dhe pyeste:

– A ka ndonjë që ka hapur syrin e zemrës?

Sepse ai kudo ku udhëtonte, besonte në vizitat e nevojshme të velive<sup>32</sup> të Allahut, sepse Zoti i Madhëruar thotë:

“...e nëse nuk e dini, atëherë pyetni njerëzit e dhikrit.” (el-Enbija, 7) Edhe Musai (a.s.), është urdhëruar t'i bëjë vizitë Hidrit<sup>33</sup>, që posedonte *diturinë ledunni*<sup>34</sup>.

Bejazidi pa një pir<sup>35</sup> shtatlartë. Nga ai vezullonte përshpirtshmëria e velive. Sytë i kishte të

32 **Velijull'Ilah:** Cilësia e njeriut që përherë është i vetëdihëm ndaj prezencës së Allahut, i devotshëm ndaj urdhëresave hyjnore, mik i Allahut, njeri i veçantë i Zotit.

33 Për informacion më të gjerë rreth figurës së Hidrit shih. Kur'ani, Suretu el-Kehf, versetet 60-82.

34 **Leduni Ilm:** Dituria Leduni; Dituri shpirtërore, e veçantë, dhuratë e Allahut.

35 **Pir:** Udhëzues shpirtëror në tasavvuf.

verbër ndaj kësaj bote, por zemra e tij përhapte rreze si një diell.

Bejazidi u ul përballë tij. Piri i tha:

*-O njeri, për ku po shkon? Për ku po e mbart rrobën e kurbetit ?*

Bejazidi u përgjigj:

*-Kam bërë nijet të shkoj për haxh; kam me vete dhe një shumë prej dyqind dirhemësh.*

Piri i tha:

*-O njeri! Ndaje një pjesë të kësaj bote me të varfërit, me të pastrehët dhe me nevojtarët e rrugës së Allahut! Hyr në zemrat e tyre dhe merrjua duatë e tyre që të zgjerohet horizonti i shpirtit tënd! Arrije një jetë të pavdekshme! Fillimisht bëji haxh zemrës tënde! Pastaj, me zemër të ndjeshme, vazhdo udhën për në haxh!..*

Qabja, është "hane-i birr" i Allahut të Madhëruar. (Pra, është një vend i mëshirshëm që e bën njeriun të kryejë plotësimin e besimit dhe e afron pranë Allahut.) Është një strehë (bejt), vizita e së cilës është një nga kushtet e Islamit. Mirëpo, zemra e njeriut është një thesar i sekreteve.

Qabja është ndërtesa e Ibrahimit, birit të Azerit, ndërsa zemra është vendshikimi i Allahut, i Cili është "Xhelil"<sup>36</sup> dhe "Ekber"<sup>37</sup>.

Nëse posedon shikim të veçantë, atëherë bëji tavaf Qabes së zemrës tënde. Kuptimi i vërtetë i Qabes,

36 **Xhelil:** Madhështor, i Cili nuk ka nevojë për asgjë.

37 **Ekber:** Më i larti.

*për të cilën ti mendon se është ndërtuar nga guri e dheu, është zemra.*

*Zoti i Madhëruar, e ka bërë të obliguar tavafin e Qabes që ti sheh, që të pajisesh me një Qabe të zemrës, të pastruar nga ndotjet.*

*Dije mirë se haxhi është një urdhëresë hyjnore e detyruar për t'u realizuar. Ki kujdes dhe këtë: nëse shqetëson apo thyen zemrën që është e pajisur me këndvështrimin hyjnor, sevapet që mund të merrje edhe po të shkoje në këmbë në haxh, nuk do të mund ta shlyenin atë gabim!"*

*Bejazidi, pasi i mori këto mesazhe nga kjo bisedë, ndjeu se zemra e tij, përfitoi një pjesë nga të fshehtat e mëshirës, prandaj e vazhdoi rrugën e haxhit me një qetësi të plotë shpirtërore."*

Mevlana, me mesazhe të tilla, ndikon dhe u jep forcë zemrave që të qëndrojnë në rrugë të drejtë, ndërsa atyre që duan të udhëtojnë për në vendet e shenjta, u thotë:

*"Kur të vijë koha e haxhit, shko që të vizitosh Qaben madhështore dhe të bësh tavaf! Nëse shkon me këtë qëllim, do e vëresh të vërtetën e Mekës!"*

Tregimi i Mevlanës jep shembullin e haxhit për të treguar se ai është një ibadet shumë delikat, prandaj, duhet të përgatitemi shpirtërisht për të.

Haxhet dhe umret e bëra pa këtë ndjenjë nuk dhurojnë rezultatin dhe përfitimin e dëshiruar. Kështu që, haxhet dhe umret duhen realizuar me këtë delikatesë shpirtërore. Ky ibadet, i



bërë me ihramet e bardha, është përpjekje për të marrë diçka nga butësia e engjëjve. Prandaj, kur je me ihram, nuk duhet gjuajtur gjah, nuk i duhet treguar gjahu gjahtarit, nuk duhet këputur me dëshirë as edhe një fije bar, apo qime. Edhe pse disa të lejuara mund të ndalohen në periudha të caktuara, ata që kanë veshur ihramin, e ndiejnë në zemër se sa larg duhet qëndruar ndaj dyshimeve dhe ndalesave. Aty, arrihet në ndjenjën e nevojshme që është dhembshuria, mëshira, mirësjellja ndaj krijesave dhe në veçanti, kujdesi për të mos i thyer zemrën tjetrit dhe të gjitha këto bëhen vetëm për Allahun.

Puna më e rëndësishme si në haxh, ashtu edhe në umre është të shfrytëzosh në maksimum kohën e kufizuar për të realizuar të gjitha detyrat e rëndësishme. Kështu që, duhet të kujdesemi në veçanti të shmangim hulumtimet e panevojshme, pra, të mos analizojmë jetën e njerëzve që nuk na interesojnë duke shpenzuar kohën kot, me fjalë boshe, sepse gjendja jonë në haxh dhe në umre shpreh edhe delikatesën e zemrës dhe thellësinë e ndjenjave tona shpirtërore.

Tek besimtarët e vërtetë nuk duhet të ekzistojë ndjenja e mospërfilljes, e nënvleftësimit dhe e turpërimit ndaj vëllait të tij në besim, sepse pikërisht aty nuk njihet njeriu se kush është, ngaqë gradët e zemrave për optikën njerëzore janë të panjohura, ndërsa për Allahun janë të ditura.



Sa mësimdhënëse është kjo ngjarje e Hazreti Halid Bagdadit e përjetuar para se të bënte sulukun<sup>38</sup> në rrugën e tasavvufit:

Hazreti Halid Bagdadi ishte nisur për haxh. Në Medine takoi një njeri me fytyrë të ndritur. Iu morën mendët nga vezullimi shpirtëror i këtij velijullahu dhe si një një i paditur që kërkon të dijë nga një i ditur, kërkoi këshilla nga ai, duke iu drejtuar:

– O Halid! Kur të arrish në Meke, nëse në Qabe vëren ndonjë gjë në kundërshtim me etikën, mos mendo keq menjëherë për të pranishmin e mos e gjyko gabim! Syrin dhe zemrën largoje prej hulumtimeve ndaj të tjerëve! Angazhohu për të zbukuruar botën tënde të brendshme!”

Me shikim të parë, kjo shprehje duket si një paralajmërim hermetik, por në të vërtetë ishte një sinjal i linjës enigmatike mes Hazreti Halid Bagdadit dhe Pir-i Kamilit<sup>39</sup>, e cila do ta bëjë atë të arrijë shkallën e tij më të lartë.

Mirëpo, Hazreti Halid Bagdadi, kur shkoi në Meke, e përjetoi aq shumë klimën shpirtërore që gjendej aty, sa pothuajse u deh shpirtërisht dhe e harroi këshillën. Kështu, me këtë ndjenjë, një ditë të premte ia tërhoqi vëmendjen shikimi që i bëri një dervish, me një veshje të parregullt

38 **Suluk**: metoda për të arritur kënaqësinë e Allahut sipas tasavvufit.

39 **Pir-i Kamil**: Udhëzuesi ideal.

dhe me pamje të çuditshme, i cili ia kishte sjellë shpinën Qabes. Me vete mendoj:

– Sa njeri i pavetëdëshëm qenka ky që i paska sjellë shpinën Qabes në një mënyrë jo të përshtatshme me etikën! Nuk e ditka madhësitinë e këtij vendi të shenjtë!

Në atë çast, pasi dolën ballë për ballë me njëri-tjetrin, ai i tha Halid Bagdadit:

– O Halid! A nuk e di ti se respekti që i bëhet besimtarit është më i vlefshëm se respekti që i bëhet Qabes, sepse zemra është këndvështrimi hyjnor? Një zemër e shëndoshë është bejtullah. Ruaje në zemër atë këshillën e atij besimtarit të Medines!...

Pasi u rrëqeth nga këto fjalë që dëgjoji, Hazreti Mevlana Halid e kuptoi se ky njeri nuk ishte si gjithë të tjerët, por një veli i madh. Menjëherë ia kapi duart, i kërkoi falje dhe iu lut duke i thënë:

– O besimtar i sinqertë! Të lutem më ndihmo, më prano si një nga salikët<sup>40</sup>!” Dervishi i fshehtë pa thellësitë enigmatike të horizontit.

– Nuk më takon mua të të edukoj! Ti do të arrish në përsosmëri nën edukimin e Hazreti Abdullah Pir-i Dehlevisë, i cili gjendet në qytetin Delhi (Xhihanabad) të Indisë! Allahu të dhëntë sukses! – i tha dhe u largua.

Këtu, si mësim të tregimit dëshiroj të sjell këto këshilla të babait tim, pastë rahmet, Musa Efendiut, kuddise sirruh:

“ Kam një këshillë për ata që ikin (në haxh apo umre); mos e neglizhoni prehjen shpirtërore atje. Merruni me botën tuaj shpirtërore, mos u merrni me punë të kota. Përpiquni të përfitoni nga pasqyrimi shpirtëror aty.

Natyrisht që sa herë shkon njeriu në haxh, ndikohet pavetëdijeshmërisht. Shumica e atyre që bëjnë haxh, janë ata që bëjnë bamirësi të mëdha. Me reflektimin shpirtëror të haxhit, shtohet bujaria, mëshira dhe dhembshuria. Këtyre njerëzve u zgjerohet zemra dhe dora me kënaqësinë dhe emocionin e besimit, dhurojnë për hir të Allahut, dhurojnë me lehtësi dhe me dëshirë çdo gjë të tyre.” (*Allah Dostunun Dünyasından*, Istanbul 1999, f. 112.)

Në versetin Kuranor thuhet:

**“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”**(Ali Imran, 92) Dhe kështu e gjithë çështja është:

## **5. Të bësh kurban për hir të Allahut.**

Qëllimi kryesor i prerjes së kurbanit gjatë kryerjes së haxhit është përkujtimi i dorëzimit të plotë ndaj Allahut (xh.sh..) të Hz.Ibrahimit e Ismailit (a.s), është arritja e mirësisë hyjnore dhe njohja e zemrave me bindjen dhe dorëzimin ndaj Tij.

Si rrjedhë të kësaj, ne arrijmë të shohim një besimtar të mbushur me dashuri ndaj Allahut, të dorëzuar plotësisht ndaj vullnetit hyjnor dhe sakrifikues të çdo gjëje, madje edhe të vetvetes.

**“Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por tek Ai arrin bindja juaj”** (el-Haxh, 37)

Mendo pak: Hz.Ibrahimi (a.s) sakrifikoi djalin, dhe Ismaili (a.s) u tregua i gatshëm për t’u sakrifikuar. Po ne çfarë po sakrifikojmë nga vetja dhe pasuria jonë në rrugën e Allahut? Sa ndikohe mi nga ajeti Kuranor: **“Besimtarët e vërtetë janë ata që blejnë xhenetin në këmbim të pasurisë dhe vetes së tyre.”** (Shih. et-Tevbe, 111)

Këto sakrifica ngelen të varura e të gatshme para nesh gjatë gjithë jetës.

## 6. Gjuajtja me gurë e shejtanit dhe nefsit.

Siç e theksuam dhe më parë, gjuajtja me gurë fillon me **gjuajtjen e shejtanit** brenda teje. Ky veprim na përkujton gjuajtjen e shejtanit të bërë nga Ibrahimi, Ismaili (a.s) dhe Haxherja për shkak të tundimit. Gjithnjë duhet të pyesim vetveten se sa jemi në gjendje t’i gjuajmë dhe t’i zhdukim dyshimet dhe gabimet që mbajmë brenda. A pasqyrohet tek ne devotshmëria dhe vendosmëria që shoqëronte Ibrahimin, Ismailin (a.s) gjatë gjuajtjes së shejtanit? A e kemi menduar ndonjëherë një gjë të tillë?

Kjo është shkalla ku duhet të arrijë besimtari që kryen haxhin dhe umren.

## 7. Ta përmendësh vazhdimisht Allahun dhe t'i lutesh Atij.

**“Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur! (Bekare, 198)**

**“Pasi t'i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: ‘Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!’ Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër.” (Bekare, 200)**

Nga këto ajete kuptojmë se besimtari që kryen haxhin dhe umren duhet ta përmendë dhe t'i lutet sa më shumë Allahut. Pejgamberi (a.s) thotë: *“Kur myslimani përmend Allahun, të gjithë gurët, pemët dhe çka ka përreth e përmendin bashkë me të. Ky adhurim shtrihet dhe përfshin gjithë rruzullin.”* (Tirmidhi, Haxh 7/828)

Këndimi i tekbirove është shumë e rëndësishme për të vendosur në zemrën e besimtarit lutjet dhe përmendjen sa më shumë të Allahut. Pavarësisht se adhurimet e tjera kryhen pa zë, tekbirot teshrikë janë urdhëruar të bëhen me zë. Në këtë mënyrë besimtari hyn në një ndërthurje të larmishme mes trupit, zemrës dhe çdo gjëje që e rrethon. Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Xhebraili (a.s.) më urdhëroi mua dhe të gjithë ato që gjenden pranë meje, të këndojnë tekbirot me zë të lartë.”* (Ebu Davud, Menasik 26/1814)

Pejgamberi (a.s.) gjithashtu na tregon se si duhet të kryhet adhurimi në këto vende të shenjta.

*“Tavafi rreth Qabes është njësoj si namazi, vetëm se këtu mund të flisni. Prandaj ai që flet gjatë tavafit, le të flasë mirë.”* (Tirmidhi, Haxhixh, 112)

Nga të gjitha këto që përmendëm mund të kalojmë tek:

### **8. Njohja e shpirtit me faljen dhe shpërblimin hyjnor.**

Në një hadith të Pejgamberit (a.s.) thuhet:

*“Kur njëri prej jush kryen Umren, i ka të falura të gjitha gjynahet deri në Umren tjetër. Nuk ka shpërblim tjetër për haxhin e pranuar përveçse xheneti.”* (Muslim, Umre, 1)

Dëshira e çdo besimtari është të vijë në këto vende të shenjta, të kryejë haxhin dhe umren sipas rregullave përkatëse dhe të kthehet në shtëpi i pastruar nga të gjitha mëkatet dhe në të njëjtën kohë të fitojë kënaqësinë e Allahut (xh.sh..)

Pejgamberi (a.s.) thekson në një hadith të tij: *“Çdo njeri që niset me qëllimin e pastër për të bërë haxhin dhe e kryen atë pa bërë asnjë gjynah, kthehet në shtëpi i dliirë porsì ditën e parë.”* (Muslim, Haxhixh 438).

Ky hadith është për të gjithë ato besimtarë që e kryejnë këtë adhurim pa lënë asnjë mangësi. Ashtu siç thuhet në hadithet e pejgamberit (a.s.), në fund të çdo haxhi të pranuar falen të gjitha mëkatet, përveç atyre që kanë lidhje me cënimin e të drejtave të njerëzve. Falësi i mëkateve është

Allahu i Madhëruar, ndërsa dhënia llogari për cënimin e të drejtave të të tjerëve, është lënë për në ditën e fundit.

Duhet të përmendim edhe një herë rëndësinë e faljes së përgjithshme të mëkateve në haxh. Nuk kemi njohuri nëse në këtë grup hyn edhe falja e namazeve të pafalura, ditëve të pa agjëruara dhe zekateve të padhëna.

Besimtari duhet t'i plotësojë këto borxhe deri në ditën e fundit të jetës. Përdryshe, ai mban dy lloje përgjegjësish për adhurimet e pakryera :

1. Përgjegjësinë e lindur nga moskryerja e tyre.

2. Përgjegjësinë e plotësimit të tyre, por jo në kohën e duhur.

Edhe në qoftë se Allahu (xh.sh..) na i fal mëkatet për mosfaljen e namazit, mosagjërimin dhe mosdhënien e zekatit, përsëri ne mbajmë mbi supë përgjegjësinë e atyre borxheve të paplotësuara. Prandaj, kërkohet plotësimi në kohën e duhur dhe dhënia e zekatit sipas kursit monetar të asaj kohe. Duhet të kërkohet falje nga Allahu për moskryerjen e tyre në kohën e duhur. Për këtë arsye, ai që niset për në haxh, duhet të mos ketë borxhe, të kërkohet të falur nëse ka cënuar të drejtat e të tjerëve dhe të plotësojë namazet e pafalura në ditët e pa agjëruara, si dhe të plotësojë zekatin e padhënë.

Shpresojmë që Allahu t'ia falë borxhet të gjithë atyre, të cilët nuk kanë pasur mundësi dhe

kohë për t'i plotësuar. Çdo besimtar duhet t'i shlyejë ato, sapo t'i jepet mundësia dhe koha. Nuk duhet lënë pas dore shlyerja e namazeve të pafalura, ditëve të paagjëruara duke shpresuar tek falja e përgjithshme e mëkateve në haxh. Shpresojmë që Allahu të na i falë edhe ato pak adhurime të pakryera në kohën e duhur.

Haxhi quhet i pranuar, kur besimtari vazhdon të punojë për fitimin e kënaqësisë së Allahut, edhe pas kryerjes së tij.

Besimtari nuk duhet të çlirohet apo lehtësohet duke menduar se i janë falur mëkatet. Të mos harrojmë se kjo është bota e sprovës. Ashtu siç thuhet në një hadith të Pejgamberit (a.s.) njeriu duke qenë një hap larg parajsës, mund të bëhet prej atyre të xhehenemit. (Shih. Buhari, Kader, 1.) Historia njerëzore është e mbushur plot me raste të hidhura të rënies para arritjes së fundit.

Për këtë arsye besimtari duhet të jetë mes frikës e shpresës dhe të ketë si princip ajetin Kur'anor: **“Adhuroje Zotin tënd deri sa të të vijë vdekja”** (Hixhr, 99)

Një haxh i kryer siç duhet, pra një haxh i pranuar, e begaton besimtarin jo vetëm me lajmin e gëzuar të faljes së mëkateve, por edhe me përgjegjësinë, faljen, mbajtjen pastër të trupit, vëllazërimin, bindjen, fitimin e ndershëm (hallall) dhe me dorëzimin, devotshmërinë e dashurinë ndaj Allahut. Përfitimet e haxhit për këtë botë dhe tjetrën nuk janë të kufizuara me kaq.



Përfitimi më i madh i besimtarit, pikë së pari është arritja e kënaqësisë së Allahut (xhsh.) dhe pastaj është bashkimi, vëllazërimi i sinqertë me myslimanët e ardhur nga të gjitha anët e botës.

Haxhi si pasqyrim i mëshirës së Allahut (xh. sh.), realizohet në një klimë të mbushur me madhështinë e emocioneve të thella të besimit, me të cilën është e mbushur zemra e besimtarit të ardhur për të kërkuar falje.

Nën një tablo shumëngjyrëshe shtrihen njerëz të vendeve dhe gjuhëve të ndryshme që jetojnë sipas zakoneve dhe traditave përkatëse. Lidhja e besimit fshin të gjitha ndryshimet dhe i bën ato si një zemër të vetme që rreh me të njëjtat ndjenja. Përjetohet një vëllazërim i bukur, i ardhur nga qetësia e bashkimit të zemrave.

Prandaj, haxhi nuk mbetet vetëm një prej rregullave të Islamit, por ai përbën një rol të rëndësishëm në përforcimin e anës morale, vëllazërore dhe politike të kësaj feje.









## VIZITA NE MEDINEN E PERNDRITSHME

Vendi ku prehet i Dërguari i Allahut (s.a.s.) në Medine, të cilin e vizitojmë si në fillim, ashtu edhe në mbyllje të akteve të haxhit dhe umres, përfaqëson vendin ku zemra fiton ngritje afektive-morale duke u stolitur me latimet e dashurisë hyjnore. Për këtë arsye duhet ta vizitojmë Ravzatu'l-Mutahhara-n<sup>41</sup> dhe nuk duhet të heqim asnjë çast nga mendja se kjo tokë mban brenda në prehrin e saj margaritarin më madhështor. Teksa prekim kujtimet fisnike dhe shkelim tokat e bekuara të mbushura plot me frymë ndjellëse të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), marrim sadopak nga pasioni i botës së Tij shpirtërore. Me emocionin që të jep përkatësia në ummetin e Tij, na lind natyrshëm dëshira të tregojmë një sjellje krejt të veçantë dhe plot respekt.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), ka thënë:

41 **Ravzatu'l-Matahhara:** Qoshku i Dllirë; vendi ku prehet trupi i Muhamedit (s.a.s.).



*“...Ashtu sikurse Ibrahim (a.s.) e caktoi zonë të ndaluar Meken Mukerreme dhe u lut për të, po ashtu edhe unë e kam caktuar Medinen e Përndritshme zonë të ndaluar...”* (Buhari, Fedailu’l-Medine, 6; Muslim, Haxh, 462)

Gonxhen e Ravzatu’l-Mutahhara-së, të dashurin tonë Pejgamberin Muhamed (s.a.s.) duhet ta duam më shumë se shpirtat tanë, pasuritë tona, fëmijët tanë, me pak fjalë më shumë se gjithçka tjetër, sepse vetëm ai meritoi të thirrej dhe të respektohej nga Allahu (xh.sh..) me fjalët **“I dashuri im”**, dashuri e cila iu pat urdhëruar edhe ummetit të tij. Për këtë arsye dijetari Islam Kadi Ijadi, duke u mbështetur në ajetin:

**“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mbarë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë dënimin e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Tevbe, 24) shkruan se:

**“Allahu e ka bërë obligim për bashkësinë myslimane dashurinë e Të Dërguarit të Tij, përkrah dashurisë që ushqehet ndaj Atij Vetë.”**

Dashuria dhe afërsia shpirtërore që ndjehet ndaj një krijese, reflektohet dhe kalon edhe tek gjërat që kanë lidhje me të, si dhe tek ndërmjetësuesit e kësaj dashurie. Për shembull, ajo që e dallon malin Uhud nga qindra, mijëra male të

tjera dhe e bën atë të dashur, është dashuria personale që pat ndier I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ndaj tij. Për këtë arsye, kur të mbërrimë në Medine është me shumë vend që të hedhim vështrimet tona të mbushura plot me dashuri, drejt malit Uhud, sepse Pejgamberi Muhamed (a.s.) pati thënë: *“Uhudi na do, edhe ne e duam atë.”* (Buhari, Xhihad, 71)

Profeti Muhamed me jetën shembullore të tij bëri që këtij qyteti t’i harrohej emri i zakonshëm **“Jethrib”** dhe t’i vendosej ai **“Medinetu’l-Munevvere”**. Me të vërtetë fakti që Medineja fitoi në zemrat e besimtarëve një dashuri të pakrahasueshme me asnjë qytet tjetër, është kujtimi i Profetit Muhamed (a.s.) që të del parasysh sa herë që e përmendim atë qytet.

Po kështu dashuria për Allahun, të kushtëzon dashurinë dhe ndjekjen e urdhrave të Profetit të Tij, Muhamedit (a.s.). Për këtë Allahu (xh. sh.) thotë:

**“Thuaj (o i Dërguari Im): Nëse me të vërtetë e doni Allahun, m’u bindni mua që edhe Allahu t’ju dojë juve...”** (Ali Imran, 31)

Në të njëjtën mënyrë, të tregosh zell dhe përpjekje në gjurmët e ndjekjes së të Dërguarit të Allahut dhe të ndjesh emocionin e dashurisë që ushqehet ndaj Tij, të mundëson të jesh nga robërit që i do Allahu (xh.sh..). As’habët fisnikë duke u përpjekur t’i afrohen të vërtetës së të Dërguarit të Allahut, si flutura që sillen rreth klimës shpirtërore të tij, atë që ishte e përkohshme

tek Ai, e konsideronin begatinë më të madhe të botës dhe me këtë mënyrë patën arritur tek mirësia hyjnore. Për këtë arsye ilaçi më i efektshëm i zemrave tona të sëmura dhe shpërfillëse është dashuria ndaj të dërguarit të Allahut dhe **“pasi-mi i traditës profetike”** që lind në fund të ndjenjës së admirimit që kemi përballë karakterit të Tij të lartë.

Nga ky aspekt, asnjë gjë nuk i paraprin dashurisë ndaj të dërguarit të Allahut: as shtëpia ku banojmë, as familja jonë, as bijtë dhe bijat tona dhe as puna a tregtia me të cilën merremi!

Pejgamberi Muhamed (a.s.) na ka hapur krahët e përkrahjes me një dashuri të pashoqe, ashtu siç vepron nëna e dhënë pas fëmijës së saj. Në çdo moment të jetës, nga buzët e tij shqiptoheshin me përgjërime fjalët: “bashkësia ime, ummeti im...”.

Profeti Muhamed (a.s.) u thotë as’habëve të tij:

*“Bëni kujdes! Unë në gjalljen time jam një pretekst sigurie. Kur të vdes, në varrin tim do të rri përherë duke thënë: “Zoti im, bashkësia ime, ummeti im” deri ditën kur të fryhet Suri...”* (Ali el-Muttaki, Kenzu’l-Ummal, vëll. 14, fq. 414)

Madje edhe në Hapësirën Hyjnore, ai pat emigruar duke thënë: “ummeti im, bashkësia ime...”.

Edhe në frymën e fundit ai e shprehte dashurinë dhe përzemërsinë ndaj nesh duke shqip-



tuar fjalët: *“Unë do të pres aty, në krye të burimit të Kevtherit<sup>42</sup>...”*.

Shkurt, me thënien e Allahut (xh.sh.):

**“Tashmë ju ka ardhur një i dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët”** (et-Tevbe, 128), profeti Muhamed (a.s.) lotonte, qeshte, brengosej, gëzohej dhe lutej gjatë gjithë jetës së tij. Ai përgjerohej përherë vetëm për ne, ummetin e tij. Madje edhe në një moment të veçantë, ashtu siç qe Miraxhi<sup>43</sup>, mendja e tij mendonte për ne, zemra e Tij rrihte po për ne...

Ai ishte një oqean aq i madh mëshire sa për hir të Tij, edhe në periudhat e shtypjes, politeizmit dhe arrogancës mbi Meke, nuk pati vërshuar asnjë zi e madhe dhe asnjë fatkeqësi. Shpagimi hyjnor nuk pat dalë në pah, sepse në mesin e mekasve jetonte Hz. Muhamed (a.s.). Këtë të vërtetë e mbështet edhe Allahu (xh.sh.), kur thotë:

**“Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t’i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij”** (el-Enfal, 33)

---

42 **Kevther**: Emri i një burimi në xhenet.

43 **Miraxh**: Ngritja e Pejgamberit (s.a.s.) lart dhe takimi i tij me Allahun (xh.sh.).

Por, kur profeti Muhamed (a.s.) emigroi nga Meka për në Medine, situata ndryshoi. Mbi politeistët e Mekës zbrisnin mynxyra qiellore. Filloi një varfëri dhe një zi e madhe buke. Njerëzve u erreshin sytë, kur i drejtonin nga qielli dhe u merrshin mendtë nga uria.

Kjo do të thoshte se ai në zemrën e të cilit ka zënë vend dashuria ndaj Hz. Muhamedit (a.s.) nuk do të pësojë asnjë dënim nga ana e Allahut (xh.sh..). Allahu që i mëshiron edhe politeistët për hir të tij, a mund ta djegë në xhehenem personin që e do atë, që e mbart në zemër një jetë të tërë dashurinë ndaj tij dhe nuk ndahet aspak nga tradita profetike e tij e lavdëruar? Vetëm ata që nuk shohin rrezet e Atij Dielli udhëzimi nuk do të mund të shpëtojnë nga dënimi.

T'ia kthesh me të njëjtën dashuri dhe përziermësi Kryepejgamberit tonë, Muhamedit (a.s.), i cili në asnjë moment nuk na ka ndarë nga gjuha dhe zemra gjatë gjithë jetës së tij audiencën e Allahut (xh.sh..), është detyra primare e zemrës së çdo sevdalliu, që ka pasur fatin të jetë nga bashkësia e Tij.

Por, kjo situatë nuk është ashtu si pandehim dhe nuk mjafton të themi vetëm me gjuhët tona "e kam në zemër". Sipas urtësisë së thënies: "Ai që dashuron dikë, e imiton atë që do dhe nuk e lëshon nga gjuha", shenja dalluese e të dashuruarve pas pejgamberit Muhamed (a.s.) reflektohet në çdo situatë dhe sjellje të tyre. Ata duhet të shtojnë në gjuhët e tyre salavatet dhe selamet dërguar Atij.

Prandaj dhe kurora e pejgamberëve, Muhamedi (a.s.), është një personalitet i madhërishtëm dhe fisnik. Kurse, sipas imam Malikut, edhe vendi ku gjendet Drita e Gjithësisë, pra varri i tij, është më i shenjtë sesa Qabja, sepse e gjithë gjithësia u krijua për hir të Tij dhe iu dedikua Atij.

Në hadithin fisnik Pejgamberi Muhamed (a.s.) thotë:

*“Ai që më viziton mua pas vdekjes, është njësoj si të më ketë vizituar në gjallje!”* (Darekutni, Sunen, II, 278)

Por edhe gjatë kryerjes së vizitës është shumë e rëndësishme edukata që ndiqet në atë moment, sepse kushti i parë i përfitimit shpirtëror të vërtetë është edukata.

Një ditë, kur imam Maliku ishte në mihrab, hyri në xhami halifi i atëhershëm Ebu Xhafer el-Mansuri. Ai bëri disa pyetje. Mes tyre nisi një bashkëbisedim fetar. Por, kur Ebu Xhafer el-Mansuri duke përhumur në rrjedhën e diskutimit e ngriti zërin, imam Maliku i tërhoqi vëmendjen duke i thënë:

– O Halif. Ule zërin këtu sepse Allahu u ka tërhequr vërejtjen edhe njerëzve më të vlefshëm se ti...”.

Para kësaj edukate të lartë qëlloi dëshmitar personalisht Halifi. Ai pyeti:

– O Imam! Kur lutem, a të kthehem nga Kibla apo nga i Dërguari i Allahut?

Imam Maliku iu përgjigj:

– E pse ta largosh fytyrën tënde prej Tij?! Ai është preteksti i Allahut për ty dhe paraardhësin tënd Ademin (a.s.) deri në ditën e gjykimit. Prandaj ti drejtohu nga Pejgamberi dhe kërko shefaatin<sup>44</sup> e Tij për në botën tjetër, në mënyrë që Allahu ta caktojë Atë ndërmjetës për ty me të vërtetë!...” (Shih Kadi Ijad, Shifau’sh-Sherif, Bejrut 1404, vëll. II, fq. 596.)

Disa mbyllin sytë para kësaj të vërtete dhe nuk i lejojnë haxhinjtë të kthehen nga Ravza. U thonë: “Jep një selam shpejt e shpejt dhe ec, kalo, kthehu nga Qabja”.

Në fakt i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) është i gjallë, ashtu sikurse nuk vdesin dëshmorët në rrugë të Allahut, por vazhdojnë të jetojnë, megjithëse kanë kaluar në botën tjetër. Nuk ka dyshim dhe është më se e vërtetë se profetët janë në grada më të larta se ata dhe në mënyrë të veçantë Zotëria i Botëve, gjendet në një gjallje të veçantë.

Abide es-Selmani qe një nga fakihët<sup>45</sup> dhe muhaddithët<sup>46</sup> e dalluar të brezit të tabiinëve. Ai qe bërë mysliman dy vjet para se të vdiste pejgamberi Muhamed (a.s.), por nuk pati fatin që ta shihte Atë. Shumë bukur e rrëfejnë dashurinë që përjetonin as’habët ndaj profetit, fjalët e Abides:

44 **Shefaat:** Ndërmjetsim me lejen e Allahut.

45 **Fakih:** Jurist Islam.

46 **Muhaddith:** Ekspert i shkencës së hadithit.

“Veç të kem timen një fije floku të Pejgamberit (a.s.) do të qe për mua gjëja më e çmuar, sesa e gjithë pasuria e kësaj bote.” (Ahmed, III, 256)

Edhe dijetari i shquar Dhehebiu, kur i pat lexuar fjalët e mësipërme të Abide es-Selmanit, i shpalosi me këto fjalë ndjenjat që përjetoi në ato çaste:

“Fjalët që ka thënë Abide es-Selmani i vlejné më shumë, sesa të gjithë pasuritë e kësaj bote; ato janë tregues i dashurisë që ka mbërritur kulmet e saj. E nëse është shprehur kështu ai dijetar i madh, kur kishin kaluar vetëm 50 vjet nga vdekja e të dërguarit të Allahut, po ne që jetojmë shtatë shekuj<sup>47</sup> pas largimit të tij prej kësaj bote, vallë ç’duhet të themi po qe se na bie në dorë një fije floku prej Tij, apo rrip nga gjurmashkat e Tij, apo një copë nga ena ku pinte ujë?

Në qoftë se një njeri i pasur do ta shpenzon-te një pjesë të mirë të pasurisë së tij për të shtënë në dorë diçka, a do ta shihje ti me syrin e personit që e bën pasurinë e tij rrush e kumbulla dhe e përdor në mënyrë jo racionale?

Jo, jo! Mos ngurro të shpenzosh ç’të kesh nga pasuria që të mund të vizitosh Xhaminë e Profetit, të cilën i dërguari i Allahut (a.s.) e ndërtoi me duart e tij, sepse kështu ti mund ta përshëndesësh personalisht me selame atje, te Huxhretu’s-Saade<sup>48</sup>, në qytetin e tij të shenjtë!

47 Është fjala për shekullin kur jetoi Dhehebiu.

48 **Huxhretu’s-Saade:** Qoshja e Lumtur

Kur të mbërrish në Medine, ndal dhe vështro mirë e mirë malin që ai deshi, Uhudin. Duaje edhe ti atë mal! Përpiqu ta mbushësh shpirtin tënd plot e përplot duke shkuar me dhjetra herë te Ravzaja, ku ulej dhe ngrihej Ai, sepse nuk mund të konsiderohesh një besimtar i përkryer, nëse nuk e do atë personalitet, që është Zotëria i Gjithësisë, më shumë sesa shpirtin tënd, fëmijët e tu e çdo gjë që posedon, me pak fjalë, nëse nuk e do më shumë se çdo gjë tjetër në botë..." (Dhehebi, Sijeru A'lami'n-Nubela, IV, 42–43)

Të parët e turqve, osmanët, të cilët përbëjnë një nga etapat më madhështore pas brezave të sahabeve dhe tabiinëve në Historinë Islame, qenë një shoqëri e ngarkuar me një dashuri të pashoqe ndaj Profetit, duke nisur që nga sulltani e gjer tek bariu i thjeshtë:

Shembujt më të hijshëm të shfaqjes së respektit dhe dashurisë ndaj Profetit siç janë: këndimi i salavateve dhe çuarja e dorës në zemër sa herë që i përmendej emri; ngritja në këmbë e të gjithë të pranishëmve, ndërsa këndohej Mevludi, ose, kur këndoheshin vargjet që flisnin mbi lindjen e Tij etj., padishahët, që përfaqësonin kulmin e atij shteti madhështor, i patën kthyer në akte të traditës sociale të bashkësisë.

Nuk ka as edhe një sulltan osman që kur i vinte posta nga Medineja, ta ketë lexuar pa marrë më parë abdest, pa e puthur dhe pa u ngritur në këmbë.

Gjithashtu, gjatë rikonstruktimit të **Xhamisë së Profetit**, punëtorët osmanë nuk kanë vënë gurë, pa qenë të pastruar me gusl dhe abdest dhe pa shqiptuar bismilanë, madje, në shenjë respekti i kanë veshur me copë rrogozash çekiçët, nga frika se mos e shqetësonin botën shpirtërore të Profetit duke dhënë kështu shembuj respekti dhe edukate të paparë.

Po në periudhën e osmanëve, regjimenti ushtarak që shpinte dhuratat perandorake në drejtim të **Medines së Ndritur**, para se të hynte në qytet, pushonte në një vend të afërt, ku përgatiteshin shpirtërisht me atmosferën shpirtërore të Medines dhe pas faljes së namazit të istihares, i qaseshin audiencës së të Dërguarit të Allahut dhe kryenin vizitën e tyre. Në kthim merrnin me vete dhe nga toka e bekuar e Medines dhe e sillnin në vendlindje në shenjë shërimi dhe respekti.

Sa nga njerëzit e dinë se stolia në majë të çallmave që shohim në miniaturat e sulltanëve osmanë, është një maskot fshese? Me këtë gjest ata e konsideronin veten si pastruesve e Haremejnëve, prandaj edhe pagat e pastruesve dhe fshirësve të Haremejnëve merreshin nga pasuria personale e sulltanëve.

Sa shembull i lartë dashurie dhe respekti është akti i ruajtjes së fijeve të mjekrës dhe flokëve të Profetit tonë si një suvenir madhështor brenda dyzet bohçesh në minberet e xhamive dhe ruajtja e tyre si shenjë mëshire dhe begatie për mbarë umetin nën emrin "**mjekra e shenjtë**".



Në thelb, respekti dhe edukata ndaj toka-ve të shenjta tek osmanllitë zë fill qysh me vetë fronin perandorak. Që në ato kohë, Stambollit, vendit të parë të kalimit nga pjesa evropiane në atë aziatike, gjatë udhëtimit për në haxh, iu vu emri "Harem". Prej andej fillonte udhëtimi i haxhit i veshur me dashuri dhe respekt ndaj Haremeve të Nderuara. Asnjë akt indiferent gjatë këtij udhëtimi nuk tolerohej.

Në këtë kontekst kujtimi i poetit Nabi, i cili në vitin 1678 pat marrë udhën për në haxh së bashku me administratën perandorake të kohës është shumë mësimdhënëse:

Nabi gjatë udhëtimit vuri re se një nga pashallarët, pa pasur ndonjë tendencë i kishte shtrirë këmbët drejt Medines. I prekur nga kjo pamje, poeti zuri të shkruajë vjershën e tij të shquar.

Pak para kohës së namazit të sabahut, ndër-  
sa karvani i afrohej Medines, Nabi dëgjoi të thir-  
rrej nga minaretë e Xhamisë së Profetit, vjersha  
që sapo kishte shkruar:

*Kujdes nga mosrespektimi,  
i thonë pusi i të Dashurit të Perëndisë këtij  
Ai është vendvrotimi hyjnor,  
i thonë post i Mustafait këtij.*

*Hyr në këtë seli me edukatë, o Nabi,  
Melekët i vijnë rrotull tokës që puthi  
Profeti!...*

Para kësaj situatë, Nabi i emocionuar, shkoi menjëherë të gjejë muezinin dhe e pyeti:



– Prej kujt e mësove këtë vjershë?

– Këtë natë i Dërguari i Allahut m’u shfaq në ëndërr dhe më tha: “Një poet i quajtur Nabi nga umeti im po vjen të të vizitojë. Ky person e ka zemrën të mbushur plot me dashuri dhe passion për mua. Për këtë arsye dilni ta prisni duke lexuar vjershën e tij nga minaretë e Medines dhe ne e çuam në vend këtë urdhër të profetit.

Nabi filloi të qajë me ngashërim. Mes lotësh tha:

– Pra, i Dërguari i Allahut më përgëzoi mua duke më quajtur nga umeti i Tij?! Domethënë Dielli i të dy botëve më pranoi në bashkësinë e Tij?!

Ja pra, pse elementi më i rëndësishëm gjatë kryerjes së haxhit dhe umres është vizita e Profetit (s.a.v.s.) dhe tavafi i Qabes që realizohet duke shkuar në ato toka me ndjenja të tilla të larta shpirtërore.

Shkurtimisht, kryerja e adhurimeve të haxhit dhe umresë, ashtu sikurse e të gjithë adhurimeve të tjera, në një konsistencë të pranueshme për audiencën hyjnore, është në varësi të pajisjes me një besim të plotë dhe me një horizont kulturre shpirtërore. Nëse mundim ta kryejmë haxhin dhe umren me cilësinë **“të pranuar”**, ne do të na pastrohen të gjitha mëkatet dhe do të fitojmë kënaqësinë Hyjnore. Rezultati që dëshirojmë, arrihet vetëm me kryerjen e këtyre adhurimeve, arrihet vetëm me atë konsistencë, me të cilën Allahu (xh.sh..) është i kënaqur.



Në këtë kontekst fjalët e mëposhtme që Hz. Shibli ia pat thënë një personi që kishte shkuar në Qabe, duke aluduar në aspektin shpirtëror të haxhit, janë një vërejtje mësimdhënëse dhe përdhëse për të gjithë udhëtarët e haxhit:

*“Kur të bësh nijetin për haxh, nuk do të numërohesh se e ke bërë atë me të vërtetë, në qoftë se nuk je penduar për të gjitha mëkatet e bëra dhe nëse nuk je drejtuar për në udhën e orientimit.*

*Po qe se nuk je zhveshur nga të gjitha mëkatet në momentin kur heq rrobat e tua dhe vesh ihramin, nuk të numërohet se e ke veshur atë me të vërtetë.*

*Po qe se uji i guslit që merr para se të nisësh haxhin, nuk i pastron edhe papastërtitë shpirtërore dhe sëmundjet e zemrës, nuk quhet se ke marrë gusl me të vërtetë.*

*Në se nuk zotohesh se do të braktisësh të gjithë haramet dhe çdo lloj fjale e sjelljeje që të largon nga Allahu, ndërsa hyn në Harem, nuk do të quhesh se ke hyrë me të vërtetë aty, ndonëse këmba jote e ka shkelur atë tokë.*

*Po qe se nuk i ke shkrirë në kënaqësi Hyjnore, dëshirat dhe vullnetet e tua epshore të tejskajshme, kur pret kurbanin, nuk do të quhesh se e ke prerë atë me të vërtetë.*

*Po qe se nuk e ke përzënë me gurë injorancën e cytjen që ke përbrenda, si dhe nëse nuk kanë zënë vend tek ti dituria dhe kultura shpirtërore, atëherë, kur gjuan me gurë shtyllën e djallit, nuk do të quhet se e ke gjuajtur me të vërtetë.*

*Me rastin e vizitës së Qabes a u shtuan darovitet hyjnore tek ti, a u mbush shpirti yt me prehje dhe ngazëllim? Në hadithin fisnik thuhet:*

*“Ata që bëjnë Haxhin dhe umren, janë të ftuarit e Allahut. Darovitja e atij që vizitohet ndaj vizituesit është një e drejtë e pashmangshme.” Po që se ti nuk e ke perceptuar këtë darovi, nuk numërohesh nga vizitorët e vërtetë...” (Shih Ibn Arabi, el-Futuhatu’l-Mekkiye, sakt. Uthman Jahja, Kajro 1986, X, 133-138.)*

Shkurtimisht veçoria rreth së cilës Hz. Shibli kërkoi të tërheqë vëmendjen, ishte zbatimi i shpalljes hyjnore:

**“Kryejini siç duhet haxhin dhe umren për hir të Allahut”** (el-Bekare, 196)

Kur kthehen nga një haxh i kryer në mënyrën më të bukur, dhuratat më të rëndësishme që shpien haxhilerët në shtëpitë e tyre, duhet të jenë bukuritë e tokave të bekuara dhe morali i lavdërueshëm i robërve të mirë që të lënë pas kujtime mësimdhënëse dhe plot urtësi, dhe përjetime të përhershme të atyre mrekullive.

Në këtë kontekst, arkitekti shpirtëror i Pakistanit, Muhamed Ikbali, duke vizituar një ditë prej ditësh haxhilerët që ishin kthyer nga Medineja, u drejtoi një pyetje që ekspozonte horizontin e tij shpirtëror prej besimtari të vërtetë:

*“E vizituat Medinen Munevvere! Me çfarë dhuratash e mbushët shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medines? Dhuratat materiale që keni sjellë, taket, tesbihë e sexhadet pas ca kohësh do të vjetërohen, do*



*të vyshken dhe do të marrin fund. A na keni sjellë nga dhuratat e Medines që nuk fishken kurrë, që i japin jetë shpirtërove?*

*A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit, drejtësi si të Umerit, ndjenjë turpi dhe bujari si të Uthmanit, klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut? A do të mund t'i falni botës Islame që sot përpëlitet në mijëra halle, emocionet e shekullit të lumturisë?"*

**Allahu (xh.sh..) na e bëftë të mundur ne të gjithëve mundësinë të përfitojmë nga bota shpirtërore e Dy Haremeve Fisnike! Na dhëntë rastin që të mund ta kryejmë Haxhin dhe Umrën me trup dhe me shpirt, dhe zemrës sonë të mbushet me ndjeshmëri dhe butësi! Na i pranoftë adhurimet e bëra, apo ato që do t'i bëjmë brenda kësaj përmbajtje!**

**Amin!**

# PERMBAJTJA

Parathënie .....	5
Haxhi Ideal dhe Umreja .....	15
Arafati .....	26
Muzdelife dhe Kurhani .....	29
Mina dhe goditja e shejtanit me gurë .....	35
Kodra Merve, Safa dhe Riti "Sa'j" .....	38
Qabja madhështore .....	39
Para se të trokasë exheli .....	43
Tevekkuli dhe teslimijeti .....	46
Masat shpirtërore për një haxh dhe umre të pranueshme. ....	50
Vizita në Medinen e përndritshme .....	75



